



# Bankieri

Botim Nr. 39  
Prill 2021

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE




**Regjistri qendror**  
i llogarive bankare



ISSN 2225-2959  
9 772225 245004

# I dashur Gent, po të lë për një më të mirë.

Zgjodha Kartën!



Kjo është një fushatë e organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave dhe ka për qëllim sensibilizimin e konsumatorit mbi përdorimin e kartave. Ajo mundësohet nga Visa.

**VISA**

**aab**  
ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

## ANËTARËT E AAB-së



## PËRMBAJTJA

## Bankieri

Nr. 39, Prill 2021

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



## REDAKSIA:

Elvin Meka

**Kryeredaktor**

Eftali Peçi

**Koordinatorë**

Dorina Zarka

**Fotografe****Design & Layout:** FCB Afirma**Shtypi nga:**  Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. Bankieri i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

## SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,  
SKY TOWER, 9/3, Tiranë  
Tel: +355 4 2280371/2  
Fax: +355 4 2280 359  
www.aab.al

## Editorial

Regjistri qendror për llogaritë bankare - Një tjetër hap drejt zbatimit efikas të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit  
Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

5

## Tema e Ditës

Regjistri qendror i llogarive bankare - një instrument inteligjent kundra pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Vasilika VJERO

6

Regjistri qendror i llogarive bankare - bashkëpunimi i DPPP me institucionet financiare

Elvis KOÇI

9

Roli i AAB-së në miratimin dhe zbatimin e ligjit për Regjistrin qendror të Llogarive Bankare

Brunilda KOSTARE

10

## Speciale

AAB me statut të ri

Dr. Spiro BRUMBULLI

11

## Intervista

Banka e Bashkuar e Shqipërisë fillon një epokë të re të "rebranding", rimodelimit dhe rienergizimit të biznesit

Amel KOVAČEVIĆ

14

## Sistemi Bankar

Masat e Bankës së Shqipërisë, që nga mbyllja, për të lehtësuar kryerjen e transaksioneve online

Ledia BREGU

16

Sfida e ruajtjes së një përqindje të ulët të huave me probleme, në kohë krize

Jola DIMA

18

Huadhënia gjatë vitit 2020 dhe cilësia e saj

Rajmond PAVACI

Elona LABINOTI

Manjola CAPO

20

## Sistemi Bankar / Intervistë

My.raiffeisen.at - Banka drejt klientit

Resmi HIBRAJ

23

## Forumi i Ekspertëve

Kuadri i ri ligjor për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive

Anxhela DERVISHI

26

Studimi i VISA-s: Rikthim në Biznes: Si e ri-formatoi COVID-19 të ardhmen e tregtisë

Vladimir DJORDJEVIC

28

Konvertimi i kolateralit në projektet e financimit të ndërtimit të infrastrukturës

Av. Ardjana SHEHI KALO

31

German Sparkassenstiftung dhe BMZ - Së bashku për të përmirësuar edukimin dhe përfshirjen financiare në Shqipëri

Anja DEINZER

33

Etika dhe e Ardhmja e Punës - nga "a mundemi" te "si duhet" - Një vështrim nëpërmjet lentes së pandemisë

Roden PAJAJ

35

## Pergjegjësia Sociale e Korporatës

38

## Java e Parasë

41

## AAB: Aktivitete - Trajtime

43

## BORDI EDITORIAL:

Silvio PEDRAZZI

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Georgios PAPANASTASIOU

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Alpha Bank Albania

Adrian CIVICI

Dekan Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

Andi BALLTA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Ervin METE

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Alpha Biznes

**Së bashku**  
gjejmë zgjidhje efikase  
për biznesin tënd!



ALPHA BANK

[www.alphabank.al](http://www.alphabank.al)  
+355 42 240 477

# Regjistri qendror për llogaritë bankare

një tjetër hap drejt zbatimit efikas të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit



**Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA<sup>1</sup>**

Kryeredaktor

Shqipëria miratoi së fundmi ligjin e ri: "Për regjistrin qendror të llogarive bankare", i cili është praktikisht një tjetër hap i rëndësishëm, në luftën e vazhdueshme kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ai ndjek kështu hapa dhe përpjekje të tjera të rëndësishme ligjore (konkretisht ligjin "Për pronarët përfitues"), për të siguruar mjetet dhe mekanizmat e duhur për një përpjekje të harmonizuar, në rrafsh ndërkombëtar, për t'u përballur, frenuar dhe luftuar paranë e pisët dhe kriminale. Në këtë mënyrë, Shqipëria bashkon forcat me vendet partnere dhe agjencitë e tjera ligj-zbatuese, në këtë luftë të vështirë dhe komplekse, që nuk është një çështje specifike e një vendi; përkundrazi, është një çështje globale. Aktualiteti ka treguar tashmë vështirësinë e madhe që haset lidhur me frenimin dhe luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sikundër shprehet dhe revista The

Economist: "Tri probleme të mëdha pengojnë luftën kundër krimit financiar: mungesa e transparencës; mungesa e bashkëpunimit dhe mungesa e burimeve."<sup>2</sup> Nisur nga kjo, është e qartë se miratimi i ligjeve dhe hartimi i kornizës ligjore në letër, nuk mjafton në këtë luftë të pafund kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo luftë do të kërkojë shumë angazhim, përpjekje, profesionalizëm dhe burime të ndryshme kapitale, nga të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit në Shqipëri.

Ligji në vetvete përbën një lehtësim të konsiderueshëm për bankat shqiptare, në veprimtarinë e tyre të përditshme operacionale, pasi ligji do të ndryshojë thelbësisht qasjen dhe praktikën aktuale të kërkimit dhe mbledhjes së informacionit përkatës nga bankat tregtare. Gjithashtu, një ligj i tillë është mjaft mbështetës për to, në kuadër të sfidave komplekse me të cilat ato përballen, gjatë pandemisë COVID-19, ku sfida kryesore është pa dyshim cilësia e portofolit të huas. Sidoqoftë, rritja e mundshme në vijim e huave me probleme dhe rritja e rrezikut të kredisë, nuk është një çështje që mund të zgjidhet, ose të trajtohet thjesht duke shtyrë këstet e huas, ose duke vijuar me ndërhyrjet nga qeveria. Shtyrja dhe copëtimi i problemit nuk nënkupton zgjidhjen e problemit; praktikisht problemi është ende atje pas kthesës dhe nuk po fshihet aspak. Sipas McKinsey<sup>3</sup>, kriza COVID-19 ka provokuar pesë ndryshime dhe sfida të mëdha në mjedisin e rrezikut të kredisë: (1) ndryshime në besueshmëri, në nivel sektori dhe nënsektori, (2) vështirësi për diferencim midis huamarrësve

në të njëjtin sektor, apo nënsektor, (3) të dhënat përkatëse mbi gjendjen e krizës janë të pakta, të vonuara dhe nuk transformohen automatikisht në vendimmarrje, (4) rikuperimi i huave me përgjegjshmëri sociale, për të përmbushur preferencat e klientëve në ndryshim e sipër, dhe (5) vala e madhe e ekspozimeve me probleme po fillon dhe ajo duhet të trajtohet me qasje të reja.

Përmbledhtazi, është e qartë tashmë se, sfida normale për bankat mbetet ende menaxhimi i rrezikut të kredisë (besueshmërisë). Sinqerisht, kjo ka qenë sfida e përditshme për bankat përgjatë thujtës nëntë shekujve të fundit, që nga themelimi i Bankës së Venecias në Itali, në vitin 1157, kur ajo prezantoi, zyrtarisht, një produkt revolucionar: Huan Bankare. Kështu, bankat dhe bankingu, gjatë gjithë ekzistencës së tyre, janë përballur me të njëjtën sfidë, e gjeneruar nga veprimtaria e tyre e zakonshme: huadhënia, kështu që është lehtësisht e kuptueshme dhe logjike që ato do të duhet të menaxhojnë me kompetencë rrezikun e kredisë, sot dhe në të ardhmen. Sigurisht, bankat ia kanë dalë të tejkalojnë me sukses vështirësitë e menaxhimit të një rreziku të tillë, siç na e tregon dhe historia, ndonjëherë duke paguar kosto të ndryshme, por kryesisht përmes risive në veprimtarinë dhe modelin e biznesit të tyre. Pra, edhe këtë herë sfida nuk është e re dhe patjetër që bankat dhe bankingu në përgjithësi, do të "fitojnë" mbi rrezikun e kredisë dhe krizën ekonomike, nëpërmjet inovacionit dhe duke ri-shpikur vetveten!

<sup>1</sup>Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës, UET.

<sup>2</sup>The war against money-laundering is being lost: [https://www.economist.com/finance-and-economics/2021/04/12/the-war-against-money-laundering-is-being-lost?utm\\_campaign=the-economist-today&utm\\_medium=newsletter&utm\\_source=salesforce-marketing-cloud&utm\\_term=2021-04-12&utm\\_content=article-link-1&etear=nL\\_today\\_1](https://www.economist.com/finance-and-economics/2021/04/12/the-war-against-money-laundering-is-being-lost?utm_campaign=the-economist-today&utm_medium=newsletter&utm_source=salesforce-marketing-cloud&utm_term=2021-04-12&utm_content=article-link-1&etear=nL_today_1)

<sup>3</sup>McKinsey: Managing and monitoring credit risk after the COVID-19 pandemic: <https://www.mckinsey.com/business-functions/risk/our-insights/managing-and-monitoring-credit-risk-after-the-covid-19-pandemic>

# Regjistri qendror i llogarive bankare

## Një instrument inteligjent kundra pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Së bashku me ligjin “Për pronarët përfitues”, i cili tanimë ka hyrë në fuqi, ligji do të sjellë ndikim pozitiv në rritjen e efektivitetit dhe koordinimit të autoriteteve ligjzbatuese në vend dhe goditjen e flukseve financiare të personave, apo grupeve të përfshira në veprimtari kriminale.



**Vasilika VJERO**

Zëvendësministër

MINISTRIA E FINANÇES DHE EKONOMISË

Ligji “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” vjen si një instrument i nevojshëm, në ndihmë të autoriteteve për zbulimin, gjurmimin, ose evidentimin e pasurive të dyshuara me prejardhje nga veprimtari kriminale, ose shkeljeve në fushën tatimore. Regjistri është një domosdoshmëri për përmbushjen e kërkesave të FATF dhe MONEYVAL, ku në bazë të vlerësimit të zbatimit të standardeve që iu bë Shqipërisë në dhjetor 2019, u vlerësua se ekziston mungesë e mekanizmeve në vend që të identifikojnë dhe përshkruajnë proceset, për marrjen dhe regjistrimin e informacionit për pronarët

përfitues, si dhe mungesa e detyrimit të organeve ligjore për të mbajtur informacion bazë dhe një regjistër përkatës/mungesë e regjistrin qendror të llogarive bankare, por dhe një kërkesë e vazhdueshme e Bashkimit Evropian, me qëllim përafrimin e plotë të kuadrit ligjor Shqiptar me Direktivat e BE-së dhe në veçanti



Regjistri krijohet si një bazë të dhënash shtetërore, ku grumbullohet, në formë të organizuar, informacioni i ruajtur në formë elektronike për çdo mbajtës të llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë, në të cilin regjistrohen të dhënat e raportuara nga institucionet financiare.



me Direktivën nr. 849/2015, ndryshuar nga Direktiva 843/2018 e BE-së: “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Së bashku me ligjin “Për pronarët përfitues”, i cili tanimë ka hyrë në fuqi, ligji do të sjellë ndikim pozitiv në rritjen e efektivitetit dhe koordinimit të

autoriteteve ligjzbatuese në vend dhe goditjen e flukseve financiare të personave, apo grupeve të përfshira në veprimtari kriminale. Gjithashtu, në një të ardhme mund të integrohet edhe me regjistra të tjerë, duke plotësuar mozaikun e plotë të informacioneve të domosdoshme për agjencitë ligjzbatuese dhe të inteligjencës në vend.

Nga ana tjetër, ky ligj është një mekanizëm shumë i rëndësishëm për njësitë e inteligjencës dhe rolin e tyre në parandalimin e financimit të terrorizmit, por edhe të pastrimit të parave, pasi mundëson qasje të shpejtë në informacion të gatshëm për përdorim.

Ndër të tjera, ngritja e regjistrin do të kufizojë numrin e personave që do të marrin dijeni për personat në hetim, apo procese të tjera, duke ulur ndjeshëm mundësinë e rrjedhjes së informacionit, si një element thelbësor për goditje efektive të pasurive me prejardhje kriminale.

Ngritja e regjistrin qendror të llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë do të ketë ndikim pozitiv edhe për institucionet financiare, pasi ato do të përqendrohen në marrjen e masave për ata klientë të cilët kanë llogari dhe shmanget një vëllim i ndjeshëm i kërkesave për të cilat rezultati është “nuk ka llogari”, duke ulur në mënyrë

të konsiderueshme edhe kostot financiare.

Ndër grupet e prekura nga ky projektligj janë:

- Çdo individ që është mbajtës i një llogarie bankare, apo kasete sigurie;

- Çdo person fizik, juridik<sup>1</sup>, apo organizim ligjor, që është mbajtës i llogarisë bankare, ose qiramarrës i një kasete sigurie, pavarësisht statusit të saj aktive, bllokuar apo e fjetur;

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, AKSHI është përgjegjëse për krijimin e sistemit, në mënyrë që të garantojë masat e përshtatshme për sigurinë e të dhënave, si dhe parimet e mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit, lidhur me përpunimin e të dhënave.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është institucioni administrues i regjistrit dhe përgjegjëse për vënien në dispozicion të aksesit të Regjistrit për subjektet e interesuara, e ndër të tjera, strukturat tatimore në nivel vendor dhe qendror, me ngritjen e regjistrit, do të kenë mundësi që përveç kryqëzimit dhe verifikimit të informacionit, në kuadër të veprimtarisë rutinë, do të kenë mundësi të veprojnë në mënyrë më efektive në mbledhjen e detyrimeve tatimore dhe bllokimin e veprimtarive të paligjshme.

Regjistri krijohet si një bazë të dhënash shtetërore, ku grumbullohet, në formë të organizuar, informacioni i ruajtur në formë elektronike për çdo mbajtës të llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë, në të cilin regjistrohen të dhënat e raportuara nga institucionet financiare. Përpunimi i të dhënave personale dhe informimi i subjektit të të dhënave personale

nga ana e institucioneve financiare do të kryhet sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Institucionet financiare duhet të krijojnë dhe të administrojnë sisteme që sigurojnë raportimin e të dhënave, në kohë reale, pas përfundimit të veprimeve me mbajtësit e llogarisë bankare, ose të kasetave të sigurisë. Institucionet financiare i raportojnë të dhënat në regjistër në mënyrë elektronike, duke përdorur mekanizmin qendror të automatizuar, sipas formatit të skedarit të raportimit.

Subjektet që kanë akses në këtë regjistër klasifikohen si:

- “Subjekte me akses të drejt-përdrejtë”: Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- “Subjekte të interesuara” janë subjektet që kanë akses në regjistër, sipas niveleve të përcaktuara në këtë ligj, apo aktet nënligjore, si:
  - Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
  - Prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm;
  - Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK);
  - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
  - Byroja Kombëtare e Hetimit;
  - Shërbimi Informativ Shtetëror;
  - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;
  - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

- Drejtoritë e taksave dhe tarifave, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

- “Subjekte që kanë të drejtë të marrin informacion” janë personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, të cilët, me kërkesë të argumentuar pranë institucionit administrues të regjistrit, kanë të drejtë të marrin informacion nga regjistri. Këto subjekte janë:
  - a) shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ose privat;
  - b) institucionet financiare;
  - c) çdo autoritet publik.

Me miratimin e ligjit, ka filluar tashmë puna edhe për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme, si dhe plotësimin e të gjithë hapësirës ligjore për ngritjen dhe popullimin e sistemit. Kështu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKSHI dhe institucionet financiare po bashkëpunojnë për të mundësuar finalizimin në kohë të regjistrit, si dhe popullimin e tij me të dhënat e kërkuara. Aktualisht është në pritje për t'u miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave, që përcakton mënyrën e aksesit në regjistër, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë lidhur me skedarët e raportimit.

Më miratimin e akteve nënligjore dhe me ngritjen e regjistrit (brenda muajit prill 2021), institucionet financiare do të duhet më tej të plotësojnë këtë regjistër me të dhëna. Informimi i publikut mbetet një sfidë për të gjithë, e për këtë qëllim, procesi do të shoqërohet me një fushatë informimi dhe edukimi, lidhur me këtë ligj dhe zbatimin e tij.

<sup>1</sup> Përfshirë shoqëritë tregtare të çdo lloji si dhe çdo subjekt tjetër juridik, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së; organizatat jo-fitimprurëse, ku përfshihen: fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jo-fitimprurëse të huaja; institucionet e ndërmarrjet shtetërore që financohen vet, ose nga buxheti i shtetit; entet e tjera publike, apo me karakter privat, të cilat e fitojnë me ligj personalitetin juridik.

abi

AMERICAN BANK  
OF INVESTMENTS

*investo*

*ne"optimizem"*



# Regjistri qendror i llogarive bankare

## Bashkëpunimi i DPPPP me institucionet financiare



### Elvis KOÇI

Drejtor i Përgjithshëm  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE,  
DPPPP

Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF), bazuar në raportin e vitit 2018 të MONEYVAL, si grupimi rajonal për zbatimin e rekomandimeve të FATF në vendet anëtare të Këshillit të Evropës, në vlerësim të zbatimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e përfshiu Shqipërinë në shkurt 2020 në listën e vendeve nën monitorim, apo si edhe njihet ndryshe “përfshirja në listën gri”. Një nga mangësitë e evidentuara ishte edhe mungesa e një mekanizmi efektiv që do të mundësonte ngritjen e regjistrat qendror të llogarive bankare, për identifikimin e çdo personi fizik apo juridik, që mban apo kontrollojnë llogari pagesash, llogari bankare, apo kasetat e sigurisë. Përmbushja e këtij detyrimi ishte tashmë një kërkesë e përsëritur edhe nga detyrimet që burojnë nga Forumi Ministror BE - Ballkani Perëndimor për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme në Tiranë, në datë 5 tetor 2018, ku përfaqësuesit

e BE-së dhe të Partnerëve të Ballkanit Perëndimor nënkruan Planin e Përbashkët të Veprimit për Anti-Terrorizmin për Ballkanin Perëndimor, në të cilin Shqipëria ka marrë përsipër harmonizimin e plotë me Direktivat e BE kundër pastrimit të parave, brenda periudhës 2020-2021 dhe ngritjen e regjistrat qendror të llogarive bankare, brenda muajit tetor 2021. Dështimi i Shqipërisë në ngritjen e regjistrat brenda këtij afati do e fuste automatikisht Shqipërinë në listën e vendeve me rrezik të lartë, ose e ashtuquajtur “E Zezë” të BE-së<sup>1</sup>.

Kërkesa për ngritjen e një regjistrat qendror të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë ka qenë një kërkesë e vazhdueshme, si për sa i përket përafrimit të legjislacionit Shqiptar me *Acquis* të BE-së, por edhe si një domosdoshmëri, në funksion të gjurmimit dhe parandalimit të përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Regjistri i centralizuar i llogarive bankare do të mundësojë institucionet ligj zbatuese të identifikojnë në kohë reale rastet e dyshuara, pa qenë të detyruar të ndjekin rrugën e komunikimit me shkresa zyrtare me secilin dhe të gjithë institucionet financiare, duke dërguar të ashtuquajturat “blanket requests”. Mungesa e tij ka pasur raste që ka ndikuar në vështirësi në identifikimin në kohë reale, apo në shpejtësinë e ndërmarrjes së veprimeve për bllokimin në kohë të aktiveve kriminale. Një nga objektivat e dakordësuar me Bashkimin Evropian është që Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa për krijimin e një ARO-je (Asset Recovery Office) dhe një zyrë e tillë nuk mund të funksionojë pa pasur paraprakisht një regjistër llogarish bankare dhe kasetash sigurie 100%

funksional.

Në rrafshin ndërkombëtar, krijimin e regjistrat të llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë duhet ta shohim si një standard uniform, i zbatueshëm në të gjitha shtetet anëtare dhe ato kandidate të BE-së, që i shërben shkëmbimit të informacionit, në kohë dhe në mënyrën e duhur. Nëse në Shqipëri komunikimi njëkohësisht me 12 banka, pavarësisht se jo-efektiv, është administrativisht i mundshëm, për vendet e mëdha një gjë e tillë është praktikisht e pamundur. Nga eksperiencia, kërkesat me emër personi (pa numër llogarie konkret) ndaj njësive simotra, në juridiksionet që nuk e kanë një regjistër të tillë, deri tani nuk ka prodhuar rezultate, pra përgjigje të përshtatshme për rikuperimin në kohë të të gjitha aktiveve të mundshme.

Në përgjigje të kësaj domosdoshmërie, prej muajit janar 2021, me hyrjen në fuqi të ligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”, institucionet ligj zbatuese shqiptare kanë tashmë një mekanizëm më shumë përtëparandaluar pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet sistemit financiar, ku sigurisht institucionet financiare janë aktorët kryesorë në “popullimin me të dhëna” të këtij regjistrat. Në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë të Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave kam ndjekur gjithë procesin prej hartimit, diskutimit të ligjit, deri në miratimin e tij. Nisur dhe nga detyrimet që Shqipëria duhet të përmbushë, në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Direktivat e BE-së, si dhe raportimit në strukturat e MONEYVAL dhe FATF, u bë e mundur hartimi dhe miratimi i këtij ligji në kohë të shkurtër dhe me cilësi.

Nga ana tjetër, ja vlen të theksohet

<sup>1</sup>[https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/banking-and-finance/financial-supervision-and-risk-management/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing/eu-policy-high-risk-third-countries\\_en](https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/banking-and-finance/financial-supervision-and-risk-management/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing/eu-policy-high-risk-third-countries_en)

se ngritja e regjistrin do të minimizojë kostot e institucioneve financiare, sa i përket komunikimit të vazhdueshëm shkresor me institucionet ligj zbatuese, si dhe investimit të shtuar të burimeve njerëzore në këtë drejtim.

Komunikimi nga ana e DPPPP-së ndodh në hapat e parë të procesit dhe rrjedhimisht edhe marrja dijani e sa më pak personave për mbledhjen e informacionit nga ana e DPPPP-së në këtë fazë është një nga parimet bazë të komunikimit. Nëse ndodh rrjedhja e informacionit dhe individ apo personi juridik, subjekt i analizës lajmërohet, hetimi administrativ dhe gjurmimi e dënimi i burimit të rrjedhjes është më i lehtë, në kushtet kur vetëm një institucion financiar është kontaktuar, pikërisht ai ku ndodhen llogaritë a kasetat e sigurisë dhe jo të gjithë institucionet financiare në vend. Në këtë aspekt, ngritja e këtij regjistri dhe sistemi i centralizuar i mbledhjes së të dhënave do të mundësojë identifikimin në kohë reale të institucionit financiar, ku individ objekt analize, është mbajtes i llogarisë bankare dhe kasetave të sigurisë, e në këtë mënyrë kjo do t'i shërbejë centralizimit të shpërndarjes së informacionit, mbledhjes së tij në një kohë shumë më të shpejtë, si dhe do të ndikojë në shpejtësinë e ndërmarrjes të procedurave ligjore. Në këtë këndvështrim, edhe bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese, në nivel kombëtar dhe me homologët në nivel ndërkombëtar, do të jetë më i efektshëm dhe të dhënat e përcjella do të jenë në kohë reale dhe më të plota.

Zgjidhja teknike po vihet në jetë nga AKSHI, duke përdorur kanalën e raportimit sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit, tashmë "live" prej kohësh, bazuar në ligjin "Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare". Kjo zgjidhje, që e vendos regjistrin nën administrimin e Tatimeve, është rrjedhojë logjike e zhvillimeve më të fundit në rrafshin ndërkombëtar.

## Roli i AAB-së në miratimin dhe zbatimin e ligjit për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare



**Brunilda KOSTARE**

Këshilltare Ligjore  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

**M**iratimi i ligjit "Për regjistrin qendror të llogarive bankare" përcakton kornizat dhe parashikimelgjoret e aksesit të sigurt mbi të dhëna të caktuara të llogarive bankare, si dhe të institucioneve me të drejtë aksesit. Sektori bankar e ka ndjerë prej kohësh nevojën e një regjistri të tillë, nga përdorimi i sigurt i të cilit të mund të arrihet një përfitim gjithëpërfshirës, si nga institucionet shtetërore/publike, në funksion të kryerjes së përgjegjësisë të tyre të ngarkuara me ligj, ashtu edhe nga sektori bankar. Ngarkesa administrative e sektorit bankar, në përgjigje të kërkesave të shumta të institucioneve që kanë të drejtë me ligj të marrin informacion mbi llogaritë bankare të klientëve, është

rritur në atë nivel sa bëhet e vështirë arritja e afateve dhe krijon një ngarkesë të panevojshme administrative.

Sektori bankar e dëshironte një ligj të tillë, prandaj dhe u përfshi në fazën e konsultimit, duke parashtruar pranë institucionit propozues disa çështje/propozime kryesore (përveç atyre me karakter teknik), për të cilat vlen të theksohet se i gjejmë të pasqyruara në ligjin e miratuar. Kështu, mund të përmendim: (i) zgjerimin e listës së institucioneve që u mundësohet aksesit në këtë regjistër, gjithmonë duke marrë në konsideratë të drejtën e tyre ligjore për marrjen e këtij informacioni, si dhe përfshirjen në këtë listë edhe të institucioneve financiare. Kjo kërkesë ishte edhe në referencë të praktikave të vendeve të tjera që kanë një regjistër të tillë; dhe (ii) saktësimi e unifikimi i procedurave të aksesit në këtë regjistër nga institucionet që e kanë këtë të drejtë dhe siguria e përdorimit të tyre.

Për sektorin bankar konsiderohen gjithashtu të rëndësishme aktet nënligjore që do të hartohen, në zbatim të këtij ligji. Industria bankare mbetet e gatshme për përfshirje në procesin e konsultimit të tyre, me qëllim të dhënies së kontributit teknik për të garantuar një zbatim pa probleme të kërkesave të ligjit.

# AAB me statut të ri

AAB kryen veprimtarinë në interes dhe mbështetje të anëtarëve të saj, duke kontribuar në përmirësimin e mjedisit të biznesit, nxitur dhe promovuar standardet dhe praktikatat më të mira bashkëkohore, e hapur për të bashkëpunuar me palë të tjera të interesuara, nga sektori publik apo ai privat.



## Dr. Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

Statuti është dokumenti thelbësor ku sanksionohen misioni, objektivat, organizimi, veprimtaria, vendim-marrja, të drejtat dhe detyrat e palëve, si dhe plot aspekte të tjera të drejtimit korporativ. Sa më gjatë një version në fuqi, aq më shumë konsolidim ka organizata. E, megjithatë, ndryshimet janë pjesë e vitalitetit të ekzistencës së saj, e fuqisë së saj për të ri dimensionuar pozicionin, rolin dhe veprimtarinë e saj.

AAB, që nga themelimi i saj si Klubi i Bankierëve Shqiptarë, ka shkuar përmes një procesi përmirësues, pasqyruës, ndryshues dhe dinamik të anës dokumentare të saj, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kohës si dhe të eksperiencave më të mira. Që me ndryshimin në Shoqata Shqiptare e Bankave dhe deri në ndryshimin më të fundit, është

fakt që statuti ka qenë boshti i mirëmbajtjes, i konsolidimit dhe i suksesit të veprimtarisë së AAB-së në vite.

Por shumë gjëra kanë ndryshuar në këto 20 vjet, si në aspektin rregullator, ligjor, ashtu edhe të mjedisit të biznesit dhe lidhjes me botën. Pikërisht, për shkak të kësaj situatë të re, nevoja për një statut të ri lindi si domosdoshmëri



AAB e zhvillon veprimtarinë bazuar në katër nivele të organizimit të saj: organit vendim-marrës (Asambleja), organit politikë-bërës dhe monitorues (Bordi Mbikëqyrës), organit ekzekutiv (Sekretari i Përgjithshëm) dhe organet mbështetëse (komitetet statutorë, zyra ekzekutive, komitetet teknike, grupet e punës, akademia e trajnimit).



e zhvillimeve në veprimtarinë e AAB-së, e përfshirjes së ndryshimeve cilësore në mënyrën e bërjes biznes, e revolucionit teknologjik drejt digjitalizimit dhe e përditësimit të praktikave dhe standardeve më të përparura të drejtimit korporativ. Për këto arsye, Asambleja e AAB-së miratoi, në 10 dhjetor 2020, statutin e ri të AAB-së. Statuti shënon një zhvillim cilësor në jetën dokumentare dhe rregullatore të AAB-së.

Statuti i ri konfirmon, për herë të parë, parimet kryesore të veprimtarisë së Shoqatës dhe anëtarëve të saj, që janë: pavarësia, angazhimi, konfidencialiteti dhe transparenca. Po në këtë kuadër, është riformuluar misioni, objektivat dhe fusha e veprimtarisë. AAB kryen veprimtarinë në interes dhe mbështetje të anëtarëve të saj, duke kontribuar në përmirësimin e mjedisit të biznesit, nxitur dhe promovuar standardet dhe praktikatat më të mira bashkëkohore, e hapur për të bashkëpunuar me palë të tjera të interesuara, nga sektori publik apo ai privat. Në fushën e veprimtarisë theksohet përfaqësimi i AAB-së në organe dhe organizata ndërkombëtare, si dhe përfaqësimi i interesit të anëtarëve të saj jashtë vendit. Midis të tjerash, cilësohet zhvillimi dhe rritja e ofrimit të edukimit financiar si dhe bashkëpunimi me aktorët publikë dhe privatë për përfshirjen financiare dhe edukuese. Gjithashtu, AAB mund të krijojë akademinë e trajnimit për edukimin dhe certifikimin e profesionistëve bankarë. AAB mbetet organizatë jo-fitimprurëse; edhe kur krijon fitim nga veprimtaria e saj, ai fitim përdoret ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve të Shoqatës.

Ky statut zhvillon dhe përshtet në mënyrë shteruese marrëdhëniet e anëtarësisë, që nga pranimi i një anëtar të ri, deri te pezullimi i anëtarësisë, apo përfundimi i anëtarësisë. Anëtarësia në AAB është vullnetare për çdo person juridik bankar, të licencuar nga Banka e Shqipërisë.

# NJË KARTË SHUMË MUNDËSI

- Këste me 0% interes
- Bonus
- Blerje Falas



Për një anëtar është e rëndësishme përmbushja e kërkesave dhe detyrimeve sipas statutit, mos cenimi i interesit të AAB-së, respektimi i praktikave të drejta dhe etikës në biznes, pa rrezikuar reputacionin e AAB-së. Anëtarësia është e shoqëruar me të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Statuti përcakton se të ardhurat kryesore të AAB-së sigurohen nga kontributi vjetor i çdo anëtar, të llogaritur sipas një metodike të miratuar.

AAB e zhvillon veprimtaritë bazuar në katër nivele të organizimit të saj: organit vendimmarrës (Asambleja), organit politikë-bërës dhe monitorues (Bordi Mbikëqyrës), organit ekzekutiv (Sekretari i Përgjithshëm) dhe organet mbështetëse (komitetet statutores, zyra ekzekutive, komitetet teknike, grupet e punës, akademia e trajnimit). Ndarja e përgjegjësisë, mënyra e zgjedhjes, linja vertikale e organizimit, përfaqësimi, e drejta e votës dhe vendimmarrja përshkruhen në mënyrë të hollësishme. E reja në këtë strukturë është fakti i krijimit të organit ekzekutiv dhe krijimi i Bordit Mbikëqyrës, në vend të Komitetit Ekzekutiv. Po kështu, përbërja e Bordit Mbikëqyrës dhe zgjedhja e anëtarëve është ri-konceptuar, për të qenë sa më përfaqësues, sipas peshës në treg që kanë grupet e bankave (të mëdha, të mesme dhe të vogla) dhe rolit që luajnë për stabilitetin financiar të vendit. Për herë të parë, kategorizimi "të mëdha" është zëvendësuar me konceptin e ri, bashkëkohor të "bankave sistemike". Statuti sanksionon që tre anëtarë të Bordit Mbikëqyrës do të jenë nga grupi i bankave sistemike, sipas kategorizimit që bën Banka e Shqipërisë për bankat sistemike. Nuk ka kufizime në rizgjedhje për përfaqësuesit nga ky grupim.

Vendimmarrja, duke respektuar kërkesat e ligjit për organizatat jo-fitimprurëse dhe parashikimet e Kodit Civil, është përcaktuar për të krijuar gjithë-përfshirje, stabilitet, transparencë dhe funksionalitet të veprimtarisë. Vendimet në Asamble merren, sipas rastit, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, me 2/3 e anëtarëve të pranishëm dhe me 3/4 e anëtarëve të pranishëm, por, në çdo rast, asnjëherë me më pak se 50%+1 vota të numrit të anëtarëve.

Duke qenë se Komiteti Ekzekutiv shuhet, detyrat ekzekutive transferohen te Sekretari i Përgjithshëm, edhe përfaqësimi ligjor i Shoqatës transferohet te ky organ (aktualisht mbahet nga Kryetari i Komitetit Ekzekutiv).

Në organet mbështetëse, përveç zyrës ekzekutive, statuti parashikon dhe përcakton komitetet teknike, të cilat, për herë të parë, ndahen në dy grupe: komitetet teknike statutores, që do të jenë shtatë (Komiteti Ligjor, Komiteti i Përputhshmërisë, Komiteti i Menaxhimit të Riskut, Komiteti i Financës dhe Kontabilitetit, Komiteti i Burimeve Njerëzore, Komiteti i Sigurisë ICT dhe IT (Teknologjia e Komunikimit dhe Informacionit), dhe Komiteti i Auditimit), dhe në komitete teknike ndihmëse, të ngritura sipas nevojës. Në dallim nga eksperiencia e deritanishme, komitetet teknike do të kenë 5 deri në 7 anëtarë, por duke ruajtur të drejtën që çdo anëtar i AAB-së të përfaqësohet të paktën në 3 komitete. Përbërja e komiteteve statutores do të miratohet nga Bordi Mbikëqyrës.

Ky ndryshim e bën komitetin më produktiv, më eficient dhe rrit zhdërvjelltësinë e marrjes së mendimit të kualifikuar nga sektori për të ndërtuar qëndrime, politika dhe propozime në nivelet brenda AAB-së, apo në diskutimet me

palë të treta. Komitetet teknike do të jenë mbështetja kryesore profesionale në veprimtarinë e AAB-së. Për shkak të rëndësisë që ka në aspektin e argumentit profesional dhe teknik, si dhe rolit që luan në furnizimin me propozime dhe përgjigjet e kërkuara për aspekte të veprimtarisë së AAB-së, Asambleja, së bashku me miratimin e statutit, miratoi edhe rregulloren përkatëse të organizimit dhe funksionimit të komitetit teknik.

Pjesë e shtuar në këtë statut të ri, në dallim nga statuti ekzistues, është sanksionimi mbi financimet, buxhetin dhe mjetet (asetet e AAB-së). Statuti përcakton se buxheti është mjeti thelbësor i menaxhimit financiar të AAB-së për një periudhë një vjeçare.

Që skema e organizimit t'i përshtatet dhe të jetë në përputhje me parimet e drejtimit korporativ, përveç strukturës organizative, statuti sanksionon detyrimin e përdorimit të auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare, si pjesë e kontrollit, transparencës dhe kërkesave ligjore.

Një e re tjetër që sjell dhe sanksionon ky statut, është e drejta e informimit të publikut, marrëdhëniet me të dhe transparenca e veprimtarisë. Statuti përcakton se qëndrimet publike mbahen nga Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimit paraprak me Bordin Mbikëqyrës. Për faktin se ky aspekt është i rëndësishëm për përfaqësimin publik të Shoqatës, vizibilitetin dhe prestigjin e saj, ky aspekt rregullohet me një rregullore të veçantë, ku përcaktohen të gjitha modalitetet e funksionimit të kësaj marrëdhënie dhe shkallët e përgjegjësisë.

Statuti i ri ka hyrë në fuqi me vendimin numër 1153/29, datë 4.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## INTERVISTA

# Banka e Bashkuar e Shqipërisë fillon një epokë të re të “rebranding”, rimodelimit dhe rienergizimit të biznesit

*Ne dëshirojmë të jemi flamurtarë të nismës së Kombeve të Bashkuara për institucionet financiare, që synon të përmirësojë cilësinë e jetës së njerëzve, pa kompromentuar atë të brezave të ardhshëm.*



**Amel KOVAČEVIĆ**

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv  
BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË

**Kohët e fundit jeni emëruar Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv (CEO) i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA). Cilat janë sfidat kryesore për këtë pozicion, në kushtet aktuale dhe ato në vijim, brenda sektorit bankar dhe sistemit financiar shqiptar?**

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) është një bankë me traditë të gjatë në tregun shqiptar, por shërbimet e saj, pozicioni në treg dhe prania e saj duhet të përmirësohen dukshëm. Situata e përgjithshme e pandemisë e bëri rrugëtimin e UBA-s edhe më sfidues. Të qenit një institucion i vogël bankar në treg të jep mundësi për një përtëritje të shpejtë. Veprimtaria më e rëndësishme për bankën është të kuptojë atë çka po

ndodh në ekonominë shqiptare dhe të identifikojë prirjet dhe problemet, në mënyrë që të tërheqë klientë të rinj, nëpërmjet zgjidhjeve financiare që plotësojnë nevojat e tyre dhe sipas nivelit të dëshiruar të përvojës së klientit. Roli i drejtimit është të projektojë në mënyrë të qartë vizionin e biznesit, që do të jetë dhe qëllimi ynë përfundimtar në vitet që vijnë. Personalisht, besoj se jemi në fillimet e një epoke të re, që do ta çojë UBA-n drejt suksesit. Aksionarët tanë, drejtimi i bankës dhe punonjësit tanë janë të vendosur ta përdorin këtë mundësi unike për të shkëlqyer përsëri, përballë klientëve tanë të çmuar. Duke qenë një bankë që përpiket të operojë në përputhje me parimet e bankingut islamik, ne kemi përgjegjësinë të kujdesemi për nevojat e klientëve nga të gjitha sferat e jetës, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre, në mënyrë që të kanalizojmë burimet financiare në sektorë dhe projekte që do të përmirësojnë qëndrueshmërinë ekologjike, përfshirjen sociale dhe përparimin e përgjithshëm në Shqipëri.

**Përtej sfidës së pandemisë COVID-19, cilat janë disa prej prioritetëve dhe objektivave që Banka e Bashkuar e Shqipërisë synon të realizojë nën drejtimin tuaj?**

Ne kemi filluar një transformim gjithëpërfshirës të produkteve, procedurave dhe proceseve

bankare, të strukturës organizative dhe teknologjisë që do të fuqizojë bankën, rrijtën tonë të degëve dhe ndërveprimin me klientët, përfshirë këtu dhe procesin e “rebranding”. Nuk ekziston ndonjë shkop magjik që do të na çojë në nivelet e dëshiruara të suksesit të biznesit, por po bëhet një punë e zgjuar dhe e palodhur me hapa të vegjël, por të rëndësishëm, që do na çojë drejt destinacionit tonë të dëshiruar. Ne nuk duam të kopjojmë, ose të ndjekim ndonjë nga lojtarët e mëdhenj bankarë në treg, por duam të shfrytëzojmë mundësitë që vijnë nga prirjet e mëdha, të tilla si: ndryshimet teknologjike, demografike dhe të sjelljes konsumatore, si dhe veçoritë dhe problemet ekonomike të vendit, që mund të synojmë t'i japim zgjidhje.

Pandemia Covid-19 po na lejon të “pastrojmë dhe rimodelojmë” shtëpinë tonë më shpejt, sepse biznesi po ecën më ngadalë se zakonisht. Sidoqoftë, planet tona janë mjaft agresive dhe ne shpresojmë t'i arrijmë ato në 2021-shin.

**Si e vlerësoni ju pozicionimin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë në sektorin bankar shqiptar dhe në sistemin financiar, lidhur me produktet dhe shërbimet bankare?**

Gama e produkteve dhe shërbimeve të UBA-s po përmirësohet shumë shpejt dhe ne shpresojmë të kemi një ofertë

tërheqëse dhe të përshtatshme për klientët e rinj, gjatë muajve në vijim. Ne do të dëshironim të njiheshim nga tregu për përvojën digjitale, aftësinë për të plotësuar menjëherë nevojat gjithnjë në ndryshim të klientit, por kryesisht dëshirojmë të identifikohemi si ofrues i shërbimeve financiare, në përputhje me sistemin tonë të besimit.

Në planin afatshkurtër, fokusi ynë është përmirësimi i shërbimeve bankare tradicionale dhe kanaleve të shpërndarjes. Ne kemi realizuar praninë e mbajtësve të kartave tona në rrjetin prej më shumë se 700 ATM në Shqipëri, pa asnjë kosto transaksioni për ta. Ne dëshirojmë të shfrytëzojmë infrastrukturën bankare ekzistuese dhe nuk

mendojmë të shpenzojmë kohë dhe fonde për të njëjtat burime, që ekzistojnë tashmë. Sidoqoftë, ne preferojmë të investojmë në partneritete strategjike dhe ekosisteme, të cilat mund të sigurojnë vlerë të shtuar në treg, avantazh konkurrues dhe hapësirë për rritjen e biznesit të bankës.

Në planin afatgjatë, ne dëshirojmë të eksperimentojmë raste jokonvencionale biznesi, të cilave nuk u është shërbyer ende financiarisht dhe teknologjikisht në Shqipëri, pasi besojmë se brezat e ardhshëm e kuptojnë bankën dhe presin nga bankat shërbime krejtësisht të ndryshme nga ato që kemi bërë ne, ose prindërit tanë në të kaluarën. Një synim tjetër afatgjatë i UBA-s

është lidhja e sektorit të korporatave shqiptare me tregje fitimprurëse, ku institucionet financiare islamike janë krijuar tregu.

Si një bankë që po përpiqet të veprojë në përputhje me parimet bankare islamike, ne kemi përgjegjësi të madhe në zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve bankare islamike, të ofruara në tregun shqiptar, në mënyrë që t'i shërbejmë më mirë klientëve tanë. Për më tepër, edhe pse jemi lojtar i vogël në treg, ne dëshirojmë të jemi flamurtarë të nismës së Kombeve të Bashkuara për institucionet financiare, që synon të përmirësojë cilësinë e jetës së njerëzve, pa kompromentuar atë të brezave të ardhshëm.



# Masat e Bankës së Shqipërisë, që nga mbyllja, për të lehtësuar kryerjen e transaksioneve online



## Ledia BREGU<sup>1</sup>

Drejtores  
Departamenti i Financës, Kontabilitetit dhe  
Sistemeve të Pagesave  
BANKA E SHQIPËRISË

**B**anka e Shqipërisë, prej disa vitesh, ka intensifikuar përpjekjet për nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike, me qëllim nxitjen e përfshirjes financiare dhe orientimin e tregut në praktika më novatore dhe efikase, të cilat promovojnë produktivitetin. Këto objektiva ndërthuren ngushtë me një sërë synimesh ndër-sektoriale, si: formalizmi i ekonomisë, krijimi i kanaleve sa më efikase në transmetimin e politikave monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik. Në këtë kontekst, masat e marra gjatë periudhës së kufizimit të lëvizjes, për shkak të pandemisë Covid-19, mund të konsiderohen si një përsheptim, ose përshtatje e masave afatgjata që Banka e Shqipërisë ka synuar, në kuadër të nxitjes së përdorimit të instrumenteve elektronike.

Fokusi kryesor i Bankës së

Shqipërisë në fushën e pagesave gjatë kësaj periudhe, në radhë të parë, ishte ofrimi i qëndrueshëm dhe sipas nevojave të tregut i sistemeve të pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë. Operimi pa ndërprerje i sistemeve të pagesave, si infrastruktura bazë e shkëmbimit të pagesave dhe tregjeve financiare konsiderohej si një domosdoshmëri jetike, jo vetëm për kryerjen e pagesave elektronike, por edhe për përcjelljen e lehtësirave monetare në tregun bankar e atë financiar.

Për sa i përket pagesave elektronike, masat e marra nga Banka e Shqipërisë lidhen kryesisht me eliminimin e kostove për përdorimin e shërbimeve homebanking, për kryerjen e transfertave në distancë nga ana e klientëve të bankave në monedhën kombëtare, për një periudhë dy mujore. Vendimi i Bankës së Shqipërisë u përqendrua në shërbimet homebanking, për shkak të ndërthurjes që këto shërbime kanë me sistemet e pagesave të operuara nga Banka e Shqipërisë dhe, si rrjedhojë, ekzistencës së hapësirave të nevojshme rregulatore për ndërhyrje në praktikën e vendosjes së komisioneve, në kushtet e një tregu të lirë. Vlen të theksohet se ky vendim u shoqërua dhe me eliminimin e tarifave të paguara nga bankat pranë Bankës së Shqipërisë, me qëllim kompensimin e kostove që ato kanë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Përtej masës lidhur me shërbimet homebanking, Banka e Shqipërisë në rolin e katalizatorit të sistemeve të pagesave dhe kryesuesit të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), adresoi edhe një sërë rekomandimesh për krijimin e kushteve për promovimin e

përdorimit të pagesave me karta dhe infrastrukturës së nevojshme për këtë qëllim.

## Ku konsistonin këto masa?

Thelbi i masave për nxitjen e përdorimit të shërbimeve homebanking gjatë periudhës së kufizimit të lëvizjes ishte lehtësimi nga pikëpamja e kostove që ato mbartin në përdorim. Ndërkohë që, nëpërmjet rekomandimeve të adresuara në rolin e katalizatorit, iu sugjerua bankave të vlerësonin çdo mundësi për zgjerimin e pagesave, që mund të kryhen nëpërmjet këtyre shërbimeve. Vlen të theksohet se kjo masë e marrë, pavarësisht se adresonte nevojat momentale, përkon me vizionin dhe objektivat afatgjata të Bankës së Shqipërisë, çka u përforcua dhe me rishikimet e kuadrit rregullator për funksionimin e sistemit AIPS dhe AECH, në qershor 2020. Konkretisht, këto rishikime, ndër të tjera, parashikojnë eliminimin e komisioneve për pagesat me vlerë të vogël, të iniciuara në mënyrë elektronike, nëpërmjet shërbimeve homebanking deri në shumën 20,000 lekë dhe diferencimin e komisioneve për pjesën tjetër të pagesave mbi 20,000 lekë, të iniciuara me homebanking deri në masën 50% të komisioneve të aplikuara për pagesat në formë letër.

Vlen të theksohet se, nxitja e përdorimit të shërbimeve homebanking, përtej promovimit të përdorimit të këtij shërbimi në vetvete, është një domosdoshmëri në kuadër të promovimit të inovacionit që do të sjellë zbatimin e ligjit "Për shërbimet e pagesave" dhe projektin Instant Payment. Nga ana tjetër, rekomandimet e Bankës së

<sup>1</sup> Mendimet e shprehura në artikull janë të autores dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.





Shqipërisë, sikurse përmendur edhe më lart, synonin nxitjen e përdorimit të kartave si mjet pagese, nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës së nevojshme për përdorimin e tyre si: në internet, pikat e shitjes, por dhe në ATM, ashtu edhe nëpërmjet lehtësimit

analizash tregu, edhe me mbështetjen e Bankës Botërore, ku nevojat për ndërhyrje janë materializuar në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël. Në këtë kontekst, vlerësojmë se, kryesisht, sfidat e evidentuara

filluar puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për këtë qëllim.

### Pritshmëritë për publikun në të ardhmen e afërt

Ajo që ne synojmë për të ardhmen, është reformimi dhe modernizimi



të procedurave dhe kostove për zotërimin e tyre.

### Dobishmëria dhe rezultatet e këtyre masave

Pagesat me karta, në vitin 2020, zunë vendin kryesor të instrumenteve të pagesave (në numër), përkatësisht me 50.11%, duke tejkaluar për herë të parë transfertat e kreditit në formë letër, ndërkohë që në vlerë pesha relative vijon me ritme të ulëta rritëse.

### Sfidat e përshpejtuara të evidentuara nga pandemia në fushën e pagesave elektronike

Meqenëse Banka e Shqipërisë, gjatë viteve të fundit ka pasur një vëmendje të shtuar në fushën e pagesave, janë hartuar një sërë

gjatë pandemisë nënvizuan më se një herë nevojën për angazhimin e të gjithë aktorëve, me qëllim nxitjen e përfshirjes financiare dhe nxitjen e përdorimit të pagesave elektronike. Gjithashtu, pandemia rikonfirmoi edhe një herë rëndësinë që ka edukimi financiar i popullsisë në përgjithësi, por edhe për të adresuar inovacionet e ndryshme të fushës. Për këtë qëllim, gjatë kësaj periudhe kemi qenë në komunikim të vazhdueshëm me Shoqatën Shqiptare të Bankave, që ndërmori masa në kuadër të edukimit të publikut, për përdorimin e elementeve të nevojshme të sigurisë për pagesat me kartë. Nevoja për nxitjen e edukimit financiar u theksua edhe një herë në mbledhjen e 6-të të KKSP, ku u rekomandua dhe ka

i tregut të pagesave, për të kryer pagesat e përditshme më lehtë dhe me kosto efektive. Këto objektiva parashikohet të materializohen nëpërmjet promovimit të inovacionit, konkurrencës, mbrojtjes së konsumatorit dhe edukimit financiar. Miratimi i ligjit "Për shërbimet e pagesave" ishte një hap i konsiderueshëm në këtë drejtim, megjithatë sfida për të ardhmen mbetet zbatimi i tij në praktikë nga aktorët e tregut. Gjithashtu, prioritet për ne do të jetë prezantimi i një produkti si: llogaria bazike, e cila nuk mbart, ose mbart kosto minimale për personat të cilët vlerësohet se nuk kanë asnjë akses aktualisht në institucionet bankare.

Për më shumë, Banka e Shqipërisë po intensifikon përpjekjet edhe për të përbushur nevoja për zhvillime infrastrukturore ku mund të përmendim: sistemin e shlyerjes së pagesave kombëtare në euro, krijimin e rregullave për operacionalizimin e Debitimit Direkt Ndërbankar, krijimin e platformave kombëtare për instant payment/Switch dhe vlerësimin e mundësive për reduktimin e kostove, të cilat mbartin përdoruesit dhe pranuesit e kartave. Të gjitha këto masa sigurisht do të mbështeten dhe me edukimin e nevojshëm financiar.

	2017	2018	2019	2020
<b>Automated Teller Machines (ATM)</b>	<b>747</b>	<b>723</b>	<b>707</b>	<b>738</b> ↑ (+31)
<b>prej të cilave:</b>				
1 - ATM me funksion tërheqje cash	747	691	707	737
2 - ATM me funksion urdhër transfertat	119	117	120	129
3 - ATM me funksion depozitim cash	107	124	171	217
<b>Terminale POS (Point of Sale)</b>	<b>7,294</b>	<b>8,726</b>	<b>11,195</b>	<b>12,147</b> ↑ (+952)
<b>prej të cilave :</b>				
1- terminale POS me funksion tërheqje cash	60	66	56	38
2- terminale EFTPOS	7,234	8,677	11,139	12,109
<b>Terminale virtuale POS për përdorimin e kartave</b>	<b>28</b>	<b>78</b>	<b>99</b>	<b>142</b> ↑ (+43)
<b>Terminale për përdorimin e parasë elektronike</b>	<b>1391</b>	<b>1700</b>	<b>2094</b>	<b>2,364</b> ↑ (+270)

# Sfida e ruajtjes së një përqindje të ulët të huave me probleme, në kohë krize

Gjetja e ekuilibrit të duhur midis paraprirjes së pasqyrimin të efekteve negative në mënyrë prudenciale dhe dhënies së kohës së nevojshme për rimëkëmbje, është sfida tjetër kritike e këtij viti.



**Jola DIMA**

Drejtuuese e Divizionit të Menaxhimit të Riskut  
INTESA SAN PAOLO BANK ALBANIA

**K**riza Covid-19 e vitit 2020 e gjeti sektorin bankar në gjendje të mirë, duke konsideruar nivelin e kapitalizimit (mjaftueshmëria e kapitalit në dhjetor 2020 ishte 18,32%), likuiditetit, si dhe prirjen e vazhdueshme rënëse të huave me probleme që prej vitit 2014, pas krizës së 2008-ës. Kjo prirje zbritëse thuhet u ndal gjatë vitit 2020, duke nxjerrë në pah një trysni në rritje.

Eksperiencia jonë si Intesa Sanpaolo Bank Albania (ISBA) ishte ajo e një rikuperimi më të shpejtë të huave me probleme sesa mesatarja e sektorit, duke u pozicionuar në mënyrë të vazhdueshme më mirë sesa tregu, që prej 2015-ës. Viti 2020 u mbyll si banka më e mirë për sa i takon normën së huave me probleme, në nivelin më të ulët historik prej 4.5%, kundrejt mesatares prej 8.11% të sektorit bankar.


Arritje të larta në rikuperimin e huave me probleme sollën një kombinim treguesish: një kosto të

ulët rreziku prej 0.37%, edhe pse në rritje nga nivelet negative të viteve të kaluara, së bashku me një përqindje të rritur mbulimi të huave me probleme. Banka vazhdon të ruajë një raport mjaftueshmërie të kapitalit mjaft të lartë, prej 21,5%, duke qenë gjithashtu pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare më të qëndrueshme të bankingut evropian, në terma të kapitalit.

Në eksperiencën tonë, mekanizmat e rikuperimit të huave me probleme, të zbatuara pas vitit 2013, kanë ndihmuar shumë në shpejtësinë dhe cilësinë e masave të marra në përgjigje të krizës së shkaktuar nga Covid-19, gjë që besoj të jetë dhe rasti për sektorin bankar në tërësi. Gjatë pandemisë, bankat, në bashkërendim me autoritetet, qeverinë dhe bankën qendrore, morën masa për të pezulluar, apo shtyrë pagesat e huave për biznese dhe individë. Pavarësisht se forma e zbatimit të këtyre masave ishte e ndryshme nga një bankë në tjetrën, pezullime apo ri-skedulime paraprake të pagesave, nëpërmjet tyre bankat mbajtën një

barrë shumë të rëndësishme, duke mbështetur ekonominë me likuiditetet e nevojshme, gjatë periudhës së mbylljes, e në vazhdimësi të krizës. Ne u ofruam gjithë klientëve tanë mundësinë e pezullimit të pagesave të huave, nga marsi në gusht të 2020-ës, dhe, më pas, mundësinë për të zgjedhur një plan pagese të re, sipas mundësive ekonomike. Kjo mbështetje u zgjerua nga financimet e posaçme, të ofruara nëpërmjet skemave qeveritare për pagesat e pagave dhe për kapital qarkullues, të zbatuara nga secila bankë, në përputhje me kapacitetet për likuiditet. Gjithsesi, sektori në tërësi u shfaq i qëndrueshëm. ISBA caktoi një kufi të veçantë për financimin e kompanive që nuk përmbushnin kriteret e skemave qeveritare të garancive, por kishin plane investimi specifike dhe të qarta, të cilat meritonin besim dhe zbatimin e investimeve të tyre specifike mund të mbështetej, duke mbështetur kështu ekonominë reale.

Duke konsideruar sa më lart, arritëm të tregojmë qëndrueshmëri në ruajtjen e përfitueshmërisë dhe sërish



të konfirmojmë aftësinë tonë për të mbështetur rritjen e ekonomisë, duke nisur një spirale efektesh pozitive, edhe në kohë krize. Kjo ishte gjithashtu rezultat i rritjes së eficiencës në shumë fusha të veprimtarisë së bankës. Për më tepër, shtytja që mori inovacioni, e përshpejtuar nga natyra e veçantë e krizës së Covid-19, mund të kontribuojë shumë në modernizimin dhe trajtimin e hershëm të huave të përkeqësuar. ISBA parashikon një qasje të re në ndjekjen e huave konsumatore, riskskulime të hershme dhe zgjidhje për rikuperime të ekspozimeve të përkeqësuar, që do të mundësohen si rezultat i automatizimit të plotë dhe digjitalizimit të huas konsumatore.

Për sa i përket prirjeve të 2021-shit, duke pasur parasysh paqartësitë e zhvillimeve të pandemisë, është e mundur që raporti i huave me probleme të pësojë trysni në rritje, kryesisht nga:

- Përkeqësimi i aftësisë paguese të huave individuale hipotekare dhe konsumatore, të shkaktuar nga rritja e papunësisë, kostot e trajtimeve mjekësore, etj.
- Turrja e dukshme e numrit të mikrobizneseve, që përbëjnë numrin më të madh të bizneseve në Shqipëri.
- Pasoja të drejtpërdrejta në sektorin e restoranteve, hotelarisë e turizmit.
- Prirja rënëse e huadhënies së re, si rezultat i kriterëve përzgjedhëse, që mban të ulët emëruesin e raportit.

Paralelisht me sa më lart, kuadri rregullator standard mbi rrezikun e kredisë, që nga hyrja në fuqi e SNRF 9, kërkon një vlerësim parashikues prudencial të humbjeve të ardhshme të huave, për t'u pasqyruar në pasqyrat financiare të bankave. Kjo qasje ndërkomëtare, e parapëlqyer dhe nga rregullatorët vendas, u lehtësua nga urdhëresat e përkohshme, të nxjerra thuasje nga të gjithë autoritetet gjatë pandemisë, për të lejuar një trajtim më të lehtë të ekspozimeve të ri-

strukturuara, në terma klasifikimi dhe provizionimi, kjo për shkak të natyrës së përgjithshme të krizës (jo të lidhur me debitorë të caktuar). Plan-pagesat e ndryshuara nuk duhet të shkaktojnë përkeqësim të klasifikimit të rrezikut, deri në mars 2021. Nisur nga këto fakte, besoj se duhet kushtuar vëmendje e veçantë në tri drejtime:

### **A. Bankat të paraprijnë me zgjidhje për huat, në momentet e para të vështirësive**

Mbetet përparësi monitorimi i ngushtë i klientëve që kanë pësuar goditje ekonomike të drejtpërdrejt nga Covid-19 dhe ata që kanë kontraktuar plan-pagesa të zgjatura në kohë, si rezultat i moratoriumit, në mënyrë që të ndërhyhet në kohë, duke minimizuar ndikimet ekonomike në pasqyrat financiare të bankës. Kjo do jetë sfida kryesore e bankave gjatë gjithë 2021-shit, veçanërisht në tremujorin e parë, siç ishte për 2020-ën.

Viti do të karakterizohet nga gjetja e zgjidhjeve ndihmuese të bankave për sektorin e turizmit dhe hotelarisë, duke paraprirë nevojat dhe përputhur me mundësitë reale ekonomike të investuesve në këta sektorë. Pavarësisht masave lehtësuese, është kritike që bankat të japin një pasqyrim të drejtë dhe të saktë të këtyre huave, duke pasqyruar menjëherë ndikimin e pësuar të pandemisë, në terma provizionesh.

### **B. Të ruhet trajtimi i harmonizuar mes aktorëve të sektorit bankar: bankës qendrore, audituesve dhe bankave**

Për këtë qëllim, është shumë e rëndësishme të ruhet harmonizimi i trajtimit mes aktorëve të sektorit: bankë qendrore, auditues dhe banka, siç është bërë deri tani, duke i qëndruar besnik qasjes së ndjekur nga urdhëresat e nxjerra gjatë 2020-ës. Bizneset që kanë qenë të shëndetshëm përpara krizës dhe janë ndikuar në veçanti nga pandemia, e që në bazë

të analizave financiare konsiderohen ende në gjendje t'i mbijetojnë krizës, sipas plan-pagesave të reja, duhet të trajtohen në mënyrë koherente, si në 2020-ën, ashtu dhe gjatë 2021-shit, për sa i takon aspekteve rregullatore.

Gjetja e ekuilibrit të duhur midis paraprirjes së pasqyrimin të efekteve negative në mënyrë prudenciale dhe dhënies së kohës së nevojshme për rimëkëmbje është sfida tjetër kritike e këtij viti. Besoj se ajo që duhet të mbizotërojë gjatë pandemisë është analizimi dhe njohja e humbjeve faktike.

### **C. Aftësi për të vazhduar mbështetjen e ekonomisë**

Gjatë 2021-shit ne presim që disa sektorë të vijojnë ecurinë e mirë, si: energjitë e rinovueshme, farmaceutika dhe agrikultura, që patën pak ose aspak efekte negative nga pandemia. Ndërtimi, gjithashtu, shfaq një kërkesë të ri-gjallëruar, të cilën e shohim të pasqyruar kryesisht në rritjen e financimit për huat hipotekare, atje ku të ardhurat e blerësve janë të gjeneruara nga sektorë të pa ndikuar drejtpërdrejt, ose tërthorazi, nga Covid-19; ndërkohë që financimi i vet kompanive ndërtuese do të mbetet shumë përzgjedhës, veçanërisht në lidhje me kërkesat ligjore dhe skema financimi të qarta të plan-bizneseve. Me kujdes do të konsiderohen, gjithashtu, pasojat e gërshetuara midis sektorëve.

**Së fundi, dy vlerësime do jenë të rëndësishme, për të kuptuar qëndrueshmërinë e bankave në terma kapitali:** ushtrimi i provës së rezistencës, kërkuar nga Banka e Shqipërisë, dhe ai i Autoritetit Bankar Evropian, që pritet t'i komunikojë së shpejti rezultatet. Ne presim që këto vlerësime të evidentojnë qëndrueshmërinë e sistemit bankar vendas, por, gjithashtu, të shërbejnë për të nxjerrë në dukje dobësi specifike të bankave të veçanta, për t'u trajtuar në kohë.

# Huadhënia gjatë vitit 2020 dhe cilësia e saj



## Rajmond PAVACI

Menaxher, Divizioni i Menaxhimit të Riskut  
ALPHA BANK ALBANIA

### Cilët kanë qenë sektorët më të financuar gjatë vitit 2020?

Pavarësisht sfidave përballë të cilave u vendos peizazhi ekonomik nga pandemia, Alpha Bank Albania përmbushi rolin e saj në mbështetje të ekonomisë kombëtare. Gjatë vitit 2020, ne vijam mbështetjen me hua për sektorin privat, përmes disbursimeve të huave të reja prej 89 milionë euro, duke ofruar financim për më shumë se 2,500 familje dhe biznese. Përveç kësaj, gjatë gjithë vitit, ne u përballëm dhe trajtuam një kërkesë të rritur për hua hipotekare dhe mbulimin e nevojave përkatëse të konsumatorit, të cilat arritëm t'i mbulonim në mënyrë efektive, duke akorduar më shumë se 18 milionë euro. Gjatë vitit 2020, për sa i përket numrit, u financuan më së shumti ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përkatësisht bizneset në sektorët e prodhimit të produkteve gjysmë të gatshme, tregtisë me pakicë, transportit dhe magazinimit të ushqimeve dhe mallrave të

tjera, edukimi dhe TIK, shërbimet shëndetësore dhe puna sociale. Me financim u mbështetën gjithashtu edhe disa korporata të mëdha, që i përkisnin sektorëve të ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme, tregtisë me shumicë, transportit dhe magazinimit të mallrave, etj. Në total, financimi i ri ishte sa 21% e stokut të portofolit të huas për bizneset dhe rreth 13% e atij për individë.

### Ku mund të pritët rritje e huave me probleme?

Ndikimi afatgjatë i pandemisë COVID-19 në disa sektorë u shoqërua me mungesa në staf dhe fatkeqësisht me mbylljen e bizneseve. Kjo shkaktoi rritje të papunësisë për profesione dhe biznese të caktuara dhe, nga pikëpamja e mbledhjes dhe rikuperimit të huave, pritët një rritje e mundshme e huave me probleme në sektorët e agjencive të udhëtimit, bareve dhe restoranteve, tregtisë me pakicë dhe shërbimeve. Banka jonë po monitoron nga afër situatën, duke u ofruar gjithashtu klientëve zgjidhje, me qëllim që të parandalojë, në mënyrë proaktive, një rritje të konsiderueshme të huave me probleme.

### Ristrukturimet e bëra gjatë vitit 2020

Fokusi kryesor gjatë vitit 2020 u vu në analizat e zgjeruara dhe qasjet vlerësuese për sigurimin e financimit të përkohshëm për sektorë më të shëndetshëm, duke rivlerësuar ekspozimet ekzistuese, në mënyrë që të mbulohej çdo nevojë e mundshme për modifikime, në afatet dhe kushtet e këtyre huave. Në këtë kuadër, u realizua, rast pas rasti, vlerësimi i rrezikut të

huas për individët dhe bizneset, në mënyrë që t'u siguroheshin atyre zgjidhjet më të mira të mundshme për nevojat e tyre specifike, duke u përpjekur të minimizonim vështirësitë e përkohshme, me të cilat ata po përballeshin. Këtu ekzistonin dy sfida kryesore: e para, identifikimi i klientëve në vështirësi të përkohshme dhe e dyta, shtrirja e analizës përtej marsit 2020, për të parë nëse po tregonin ecuri të dobët, apo ishin të tillë edhe përpara kësaj periudhe. Ndërkohë, në situata të vështirësive të përkohshme, kryesisht të lidhura me çështje të likuiditetit, banka procedoi, përveç shtyrjeve të pagesave dhe moratoriumeve, edhe me ristrukturime afatmesme, në një madhësi prej më shumë se 1.2 milionë euro, për disa qindra individë dhe për rreth 75 biznese, me një stok huaje prej më shumë se 25 milionë euro.





### Elona LABINOTI

Drejtoresh e Departamentit Operacional dhe Administrimit të Kredive  
FIRST INVESTMENT BANK - ALBANIA

### Cilët kanë qenë sektorët më të financuar gjatë vitit 2020?

Pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia, Fibank vijoi me huadhënien gjatë gjithë vitit, madje mund të themi se intensifikua mbështetjen ndaj klientëve tanë, për t'i ndihmuar ata në këtë periudhë të vështirë. Ky fakt dëshmohej edhe nga rritja e portofolit të huas me rreth 20%, ndër rritjet më të larta në sistemin bankar.

Reagimi i menjëhershëm i Qeverisë dhe Bankës Qendrore dha hapësirë për frymëmarrje dhe gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për klientët tanë. Dritarja për ristrukturim ofroi zgjidhje për të gjitha llojet e huave dhe bëri të mundur që ndikimi të mos ishte aq i menjëhershëm dhe aq i ashpër krahasuar me parashikimet. Të gjitha përpjekjet tona, në muajt e parë, u përqendruan në gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe të përshtatur për plotësimin e kërkesave të klientëve për huat e tyre. Ne caktuam ekspertët më të mirë, jo vetëm që merren me huadhënien, por të gjitha burimet

e tjera të brendshme për të përballuar situatën.


### Ku mund të pritjet rritje e huave me probleme?

Sidoqoftë, raporti i huave me probleme u mbajt në një nivel shumë të mirë, madje edhe më i ulët krahasuar me muajin dhjetor 2019. Kjo u ndihmua jo vetëm nga fluksi i reduktuar i huave të reja me probleme, por edhe nga një nivel shumë i mirë i disbursimeve dhe huave të fshira. Fibank Albania investoi në mënyrë të konsiderueshme në përshtatjen me ndryshimet dhe teknologjitë e reja. Në këtë drejtim, gjatë vitit përmirësuam platformën e-banking dhe futëm në përdorim një platformë bankare mobile me përdorim shumë të lehtë, e cila u mundëson klientëve tanë që të kryejnë shumicën e operacioneve në internet. Përmë tepër, investuam në ATM-të e reja të teknologjisë së lartë, të cilat u ofrojnë mbajtësve të kartave mundësinë e pagesave 24/7 përmes funksionalitetit të depozitimit të parave në ATM. Vlen gjithashtu të përmendim investimet tona të mëtjeshme në rritjen e sigurisë, si: prezantimi i funksionit të sigurisë 3D për të gjitha kartat dhe përmirësimet e sistemeve në zgjidhje më digjitale. Pavarësisht nga shumë sfida dhe vështirësi, rezultatet financiare të Fibank ishin dukshëm pozitive dhe perspektiva e digjitalizimit hapi rrugën e saj për shumë projekte të reja interesante, që do jenë në fokusin tonë në vijim.

### Ristrukturimet e bëra gjatë vitit 2020

Lidhur me ristrukturimet, u përdorën mënyra të ndryshme për të lehtësuar afatin dhe kushtet e huas, si: ulja e kësteve për një periudhë të caktuar, zgjatja e maturimit, lejimi i klientëve të kenë

periudhë mospagimi për kryegjënë dhe interesin etj. Si rezultat, më shumë se 40% e portofolit tonë pati një ndryshim në termat e tij fillestarë, për shkak të efekteve ekonomike nga pandemia. Ndikimi më i madh është sigurisht në huat e bizneseve. Huat e reja tejkaluan shumën 43 milionë euro, me një rritje neto të portofolit më shumë se 19 milionë euro. Pothuaj gjysma e huave të reja iu dha klientëve individë dhe gjysma tjetër u dha për sektorë të caktuar ekonomikë, si: prodhimi, përpunimi, ndërtimi dhe tregtia.





## Manjola CAPO

Drejtoresh e Divizionit të Kredisë  
TIRANA BANK

### Cilët kanë qenë sektorët më të financuar gjatë vitit 2020?

Viti 2020 ishte një sfidë për gjithë ekonominë botërore, sistemin bankar dhe për vet Tirana Bank, që nuk mund të përbënte përjashtim. Përtej të gjitha vështirësive që solli ky vit, përfshirë dhe pasiguritë për të ardhmen, banka jonë rikonfirmoi misionin e saj, në mbështetje të ekonomisë vendase, duke ndjekur një model biznesi që siguron rritje të vazhdueshme. Në këtë këndvështrim, Tirana Bank nuk rreshti në asnjë moment kreditimin e biznesit dhe individëve, me kujdesin e shtuar për cilësinë e kësaj huadhënie dhe diversifikimin e rrezikut ndërmjet sektorëve. Kështu, ndër sektorët më të financuar nga banka, në vitin 2020, ishin ai i ndërtimit, duke konsideruar rritjen e numrit të projekteve në zhvillim, sektori energjetik, i cili vazhdon të jetë një sektor me hapësira të konsiderueshme për rritje kapacitetesh dhe përmirësime të eficiencës, tregtia, industria përpunuese, e sigurisht huat për individë, me fokus huan hipotekare.

### Ku mund të pritet rritje e huave me probleme?

Në parantezë, duhet thënë që masat e marra nga sektori bankar në tërësi, si dhe nga Qeveria dhe Banka e Shqipërisë që në fillim të pandemisë e në vazhdim, sigurisht ndikuan pozitivisht në mbajtjen nën kontroll të cilësisë së portofolit të huas. Tirana Bank mbajti një qëndrim proaktiv ndaj klientëve të saj, duke adresuar me shpejtësi problematikat e vështirësive në pagesa, si nëpërmjet zbatimit masiv të moratoriumeve të kërkuara nga institucionet e sipërpërmendura, ashtu dhe nëpërmjet trajtimit individual të klientëve specifikë, që operonin në sektorët më të prekur nga pandemia, por dhe segmente të tjerë. Mbi bazën e këtyre ndërhyrjeve, tashmë vërehet një kthesë pozitive në ecurinë e një mase të gjerë klientësh, të prekur nga pandemia Covid-19. Në këtë mënyrë, pritshmëritë tona, bazuar në plane të detajuara të strukturave të biznesit, rrezikut dhe të rikuperimit të huave, janë për një ulje të nivelit të huave me probleme, si në përqindje të totalit të portofolit, ashtu dhe në vlerë absolute.

### Ristrukturimet e bëra gjatë vitit 2020?

Ristrukturimet e bëra gjatë vitit 2020 në Tirana Bank u shtrinë në rreth 30% të portofolit të huas. Shpërndarja më e madhe në numër klientësh ishte sigurisht në klientët individë, ndërkohë që në vlerë përfshijnë, në pjesën më të madhe të tyre, klientët e biznesit të madh. Ristrukturimet u aplikuan në forma të ndryshme të ri-skedulimit të plan-pagesave të klientëve tanë, duke filluar që në mars 2020 me moratoriumet në pagesat e kryegjësë dhe interesat e huave, për një periudhë 6 mujore, si për klientët individë, ashtu dhe për ato

biznes. Këto pagesa u ri-skeduluan sipas kërkesës së klientit dhe gjykimit të bankës, përgjatë kohëzgjatjes së huas, në fund të maturimit, apo dhe shpërndarje të tjera më specifike, të lidhura ngushtë me ciklet e biznesit dhe të ardhurat e klientëve.

Përgjatë vitit 2020 e në vazhdim, është bërë dhe po behet një monitorim e mbikëqyrje e shtuar për të gjithë portofolin e huas, me fokus te klientët biznes që operojnë në sektorët e prekur nga pandemia Covid-19. Gjithashtu, është analizuar me vëmendje edhe përhapja e efekteve financiare të pandemisë në sektorë dhe klientë që bashkëveprojnë me ata të përmendur më lart. Qëllimi ka qenë dhe mbetet ristrukturimi në kohë dhe i hershëm i huave për klientët që shfaqin, apo parashikojnë vështirësi në pagesat e detyrimeve, me qëllim rimëkëmbjen e bizneseve dhe individëve dhe ruajtjen e cilësisë së portofolit.



# My.raiffeisen.al

## Banka drejt klientit

Shumë shpejt banka do të nxjerrë produkte të reja digjitale, duke synuar që, brenda vitit 2021, klientëve tanë t'u ofrohen online edhe produktet më të rëndësishme e komplekse bankare, duke e bërë kështu realitet ëndrrën që Banka Raiffeisen të jetë në dorën e tyre përmes celularit, 24/7.



### Resmi HIBRAJ

Drejtor i Kredisë PI & Bankingut Digjital  
RAIFFEISEN BANK ALBANIA

### Çfarë është platforma my.raiffeisen.al?

Platforma my.raiffeisen.al është një nga risitë e fundit digjitale, që Banka Raiffeisen sjell në mënyrë të vazhdueshme për klientët e saj. Objektivi i Raiffeisen është që, përmes teknologjisë së fundit e në mënyrë sa më të thjeshtë e intuitive, të çojë bankën aty ku është klienti dhe jo të detyrojë klientin të vijë aty ku është banka. Kjo është e ardhmja e bankingut, një realitet i pashmangshëm edhe për tregun tonë, që në mënyrë tradicionale ka pasur pirjen ta bazojë ofrimin e shërbimeve bankare përmes ndërveprimit personal bankier-klient. Risitë digjitale kanë për qëllim që ta ruajnë vlerën e shtuar të vëmendjes personale që banka do t'i kushtojë klientit dhe ta përmirësojnë

atë, duke e kanalizuar atë drejt produkteve me komplekse, si: kreditimi apo investimet.

Platforma my.raiffeisen.al erdhi si një zhvillim i natyrshëm i progresit që ka bërë Raiffeisen gjatë 5 viteve të fundit, në përputhje me strategjinë e saj për ta transformuar eksperiencën bankare të klientëve. Strategjia jonë përqendrohet në zhvillimin e kulturës së inovacionit, digjitalizimin e produkteve/shërbimeve, me fokus bankingun në celular, dhe partneritetin me fintech-sat shqiptarë.

Fillimisht ne sollëm aplikacionin mobile dhe web, Raiffeisen On, i pari në treg që krijoi mundësinë për të bërë të gjitha pagesat, transfertat, rimbushjet telefonike, investimet dhe aplikime për produkte të ndryshme tërësisht online, 24/7. Me tej erdhën risitë e tjera, si: pagesat digjitale person-person, përmes KUIK, si dhe person-biznes, përmes Scan&Pay, duke revolucionarizuar kryerjen e pagesave, për t'u ndjekur më vonë nga ndihmësja e parë digjitale në treg, RONA, ku përmes teknologjisë së inteligjencës artificiale klientët marrin përgjigje për pyetjet e tyre, pa pasur nevojë të telefonojnë shërbimin e klientit, ose të shkojnë në degë.

Hapi tjetër cilësor, e sigurisht më ambicioz nga pikëpamja e kompleksitetit dhe përmbushjes së detyrimeve rregullatore/ligjore që ofron legjislacioni shqiptar, është ofrimi te klientët e rinj i mundësisë për t'u bërë pjesë e Raiffeisen

përmes një procesi tërësisht online, pa qenë nevoja të vizitojnë degën. Domethënia e një risie të tillë për tregun tonë është e jashtëzakonshme dhe do përmirësojë ndjeshëm cilësinë e shërbimit për klientin.

Pandemia COVID-19, përmes kufizimeve dhe distancimit social të paprecedent për shoqërinë tonë, evidentoi nevojën për zgjerimin e shërbimeve digjitale në çdo sferë të ekonomisë, përfshi këtu dhe sektorin bankar. Pamjet e shpeshta të radhëve të gjata përpara bankave dhe institucioneve të tjera ishin një dëshmi e qartë që vendi ynë, dhe bankat si pjesë e tij, janë ende prapa prirjeve globale. Banka Raiffeisen, e vetëdijshme për situatën dhe pasojat, intensifikoi punën e nisur përpara vitit 2020, për të mundur pranimin e klientëve të rinj tërësisht online dhe platforma my.raiffeisen.al është oferta jonë digjitale për klientët e rinj.

### Si u lehtësohet klientëve eksperiencia bankare?

Platforma my.raiffeisen.al sjell disa përfitime të rëndësishme për bankën dhe klientët. Për bankën është një mundësi për t'i ofruar klientit shërbim të shpejtë, komod, në kohë reale dhe tërësisht falas. Kështu, ajo diversifikon më tej kanalet përmes të cilave ofrohen produktet dhe shërbimet bankare. Edhe me domethënëse janë përfitimet për klientët. Tashmë është fakt që, në më pak se 15 minuta, qytetari bëhet klient i ri i Raiffeisen Bank, duke

hapur një llogari të re, duke marrë një paketë me përfitime të shtuara, aplikon për një kartë debiti pa kontakt, etj. E gjitha kjo mundësohet përmes plotësimit të pyetësorit me të dhënat personale dhe identifikimit me video, si dhe firmës digjitale.

Rëndësia e këtyre përparësive është e jashtëzakonshme, kur mendohet se sa kohë e çmuar do të duhej të harxhohej në degë, duke pritur në radhë, pa përmendur këtu rrezikun e COVID-19, si pasojë e ekspozimit ndaj kontaktit të shtuar.

### Na njihni me tepër me procesin e firmës digjitale/elektronike

Firma digjitale/elektronike mundësohet përmes një procesi të sofistikuar dhe të sigurt, duke garantuar identifikimin e klientit, ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe ruajtjen e provës që klienti ka firmosur në formë digjitale në arkivën tonë virtuale. Firma digjitale është një risi edhe për tregjet e zhvilluara, e në këtë këndvështrim, jetësimi nga Raiffeisen si banka e parë në treg, ka vendosur një precedent të rëndësishëm, që do ta zhvillojë më tej sektorin bankar. Procesi është i thjeshtë dhe klientit, pasi ka kryer gjithë procesin e regjistrimit dhe aplikimit, i dërgohet dokumenti që duhet firmosur në formë digjitale nga ana e bankës. Klienti hap aplikacionin e firmës digjitale, hap dokumentin PDF për ta lexuar/verifikuar dhe vetëm me një klikim e firmos dokumentin, i cili me tej i përcillet bankës automatikisht.

### Tashmë që klientët mund të hapin një llogari online, kur do të kenë ata mundësi që të përfitojnë edhe produkte të tjera, duke aplikuar online?

Hapja e llogarisë nuk është një proces i izoluar, por shoqërohet me mundësinë për të aplikuar, apo shprehur interes edhe për produkte të tjera të bankës. Që në momentin

e parë të aplikimit klientët kanë mundësinë të zgjedhin opsionin që dëshirojnë, nëse duan vetëm një llogari të thjeshtë, apo një paketë që ofron një numër shërbimesh të rëndësishme pa kosto (vetëm kostoja mujore e paketës). Bashkë me llogarinë, klienti ka mundësinë të aplikojë për kartën e debitit, duke mundësuar depozita dhe tërheqje nga llogaria.

Pas hapjes së llogarisë, klientit i mundësohet shkarkimi i aplikacionit mobile Raiffeisen On, ku mund të kryhet çdo transaksion bankar që kryhet në degë. Njëherësh, klienti ka mundësi të fillojë të përdorë risinë digjitale KUIK, që mundëson dërgimin e parave drejt kontakteve personale përmes celularit, brenda pak minutave. Ky shërbim është ndër më të kërkuarit në tregjet e zhvilluara dhe është përqafuar me entuziazëm nga mbi 35,000 klientë të Raiffeisen.

Raiffeisen On ofron dhe shumë shërbime të tjera të pagesave dhe mirëmbajtjes së llogarisë, si dhe mundësinë për të bërë blerje përmes Scan&Pay. Njëkohësisht, klienti ka mundësinë gjithashtu të shprehë interesin edhe për produkte të tjera që banka ofron.

### Duke pasur parasysh nevojën e tregut, cilat do të jenë risitë digjitale që Raiffeisen do të ofrojë në të ardhmen për klientët e saj?

Duke iu rikthyer diskutimit me lart për revolucionin digjital që po përjeton vendi ynë, është e evidente që për secilin prej nesh teknologjia po e ndryshon mënyrën sesi ne e organizojmë kohën dhe veprimtaritë tona, në një formë që nuk imagjinohej pak vite më parë, e këtu bankat nuk bëjnë përjashtim. Gjatë 2020-ës Raiffeisen e ndryshoi në mënyrë të shpejtë dhe efikase organizimin e punës, duke punuar në mënyrë virtuale, për të mbrojtur shëndetin e punonjësve, si dhe për të garantuar

ofrimin e shërbimit për klientët në mënyrë të pandërprerë, pavarësisht sfidave serioze që solli COVID-19. Ishte pikërisht progresi ynë digjital i viteve të fundit, që mundësoi bankën të dilte më fortë nga kriza dhe me një bazë më të madhe klientësh. Ne jemi të vendosur për ta zgjeruar më tej gamën e shërbimeve digjitale që ofrojmë; nevojat e tregut për shërbime të reja digjitale të shpejta e të sigurta do të vijnë vetëm në rritje dhe Raiffeisen do të vijojë të mbetet gjithmonë një hap përpara tregut, për t'i paraprirë kërkesave të klientëve.

Shumë shpejt banka do të nxjerrë produkte të reja digjitale, duke synuar që, brenda vitit 2021, klientëve tanë t'u ofrohen online edhe produktet më të rëndësishme e komplekse bankare, duke e bërë kështu realitet ëndrrën që Banka Raiffeisen të jetë në dorën e tyre përmes celularit, 24/7. Klientët presin që marrëdhënia me bankën të vijojë më tej, gjithmonë dinamike dhe në përputhje me nevojat e tyre, që evoluojnë çdo ditë. Raiffeisen synon t'i përbushë këto kërkesa përmes një eksperience digjitale të lehtë dhe transparente, duke i ofruar klientit diçka më shumë: një përfitim, shpërblim për besnikërinë, një ofertë, pikërisht kur dhe ku i duhet klientit.

Ky është misioni dhe premtimi ynë digjital!





# Kuadri i ri ligjor për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive

*Parashikimi në ligj i formave dhe strukturave të reja të sipërmarrjeve përbën potencial për zhvillimin e këtij tregu, duke krijuar mundësi të reja investimi për investuesit dhe qytetarët shqiptarë dhe njëkohësisht rrit aksesin në burime të reja financiare për biznesin shqiptar.*



## Anxhela DERVISHI

Drejtoresh

Drejtoresha e Mbikëqyrjes së Fondeve të Investimit dhe të Fondeve të Pensioneve Private

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE, AMF

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) është një nga tregjet financiare jobankare mbi të cilat AMF-ja ushtron funksionin rregullator dhe mbikëqyrës, me synim stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Nga këndvështrimi i aktiveve aktualisht ky është tregu më i madh për t'u mbikëqyrur nga AMF-ja.

Industria e SIK në Shqipëri është relativisht e re dhe nisi me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.10198, datë 10.12.2009: "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", i ndryshuar dhe vijoi me licencimin e shoqërive administruese dhe fondeve të investimit që ato administrojnë. Aktualisht, deri në fund të vitit 2020, për të kryer veprimtari në

këtë treg janë licencuar pesë shoqëri administruese dhe nëntë fonde investimi. SIK janë investues institucionalë të rëndësishëm dhe gjatë këtyre viteve ky sektor ka kaluar përmes ndryshimeve të rëndësishme strukturore, duke përbërë kështu një hap pozitiv drejt zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe mbështetjes së tregut financiar në përgjithësi. Në këto kushte, në fokusin e punës mbikëqyrëse ka qenë forcimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së këtij tregu, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator si dhe rritjes së transparencës së tyre kundrejt investuesve.

Me synim përmirësimit dhe zhvillimit e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator për tregun e fondeve të investimeve, si dhe në një kohë kur dinamika e këtij tregu ka pësuar zhvillime të mëdha, u miratua Ligji i ri: "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive". Ky Ligj, që hyri në fuqi më 20.06.2020, shfuqizoi ligjin Nr.10198 datë 10.12.2009 me të njëjtin titull. Duhet theksuar se ky ndryshim ligjor u ndërмор edhe në kuadrin e përafrimit të këtij legjislacioni me Direktivat e BE (DSIKLVT dhe DAFIA), pasi ligji ekzistues ishte hartuar që në vitin 2009 dhe ndryshuar në vitin 2016. Puna për hartimin e këtij ligji të ri, u realizua në kuadër të projektit: "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi në Zhvillimin e Tregut të Kapitalit", i financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe

mbështetur nga Banka Botërore.

Risitë e ligjit të ri për sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) kryesisht konsistojnë në:

- Harmonizimin e kërkesave për themelimin e SIK me ofertë publike, me pjesëmarrje të hapur, ose me intervale, me kërkesat e Direktivës për SIKLVT (UCITS), pavarësisht nëse fondi është sipërmarrje e investimeve kolektive, apo fond i investimeve alternative;
- Mundësinë e ngritjes së formave të reja të organizimit të SIK, siç janë fondet e investimeve alternative, të cilat janë të përshtatshme për të bërë investime jo-likuide të tilla si: pasuri të paluajtshme;
- Rritjen e mbrojtjes së investuesit përmes rritjes së kërkesave në dhënien e informacioneve shpjeguese në dokumentacionin që i vihet në dispozicion investuesve të SIK me ofertë publike;
- Më shumë dispozita në lidhje me bashkimin dhe shkrirjen e fondeve, si dhe për ruajtjen, likuidimin dhe mbylljen e fondeve dhe shoqërive administruese dhe depozitarëve;
- Shtimin e kompetencave të AMF-së, të cilat nuk ishin të mjaftueshme në mbikëqyrjen e këtij tregu, siç është: ndërmarrja e hetimeve krahas inspektimit, zbatimit dhe në veçanti masat për kundërvajtje, bashkëpunimi rregullator vendas dhe


# Bëni të tuat!

Shuma deri në  
**1.500.000** Lekë

Afat  
deri në **7** vjet

Normë interesi  
duke filluar nga **5.8%**

Aplikim  
Online **0** Komision



ndërkufitar, për të siguruar mbrojtje të përshtatshme për investuesit;

- Së fundmi, janë shtuar dispozita në lidhje me administrimin ndërkufitar dhe marketingun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, për t'u përputhur me kërkesat e DAFIA (Direktivës mbi Administruesit e Fondeve të Investimeve Alternative), por me dispozita kalimtare ato nuk do të zbatohen deri në kohën kur AMF nxjerr rregullore për këtë qëllim, të cilat nuk duhet të jenë më vonë sesa data kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

### Format e reja të organizimit të SIK dhe zhvillimi i atyre ekzistuese

Ligji i ri mundëson krijimin e formave të reja të SIK dhe zhvillimin e atyre ekzistuese. Sa i përket sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, ligji i ri lejon që këto të marrin njërin prej formave të mëposhtme:

- Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur në formë kontraktore (fond investimesh) UCITS dhe jo UCITS. Ligji 10198 datë 10.12.2009 i lejonte këto lloj sipërmarrjesh, të cilat kanë kryer veprimtari në Shqipëri, pasi janë licencuar nga AMF-ja;
- Fonde me intervale me formë kontraktore, të cilat teknikisht janë fonde të investimeve alternative. Kjo është një formë e re organizimi sipërmarrje, e cila u përshtatet tregjeve të letrave me vlerë me likuiditet më të ulët, sepse i shesin dhe i shlyejnë kuotat vetëm dy herë në vit;
- Sipërmarrjet me pjesëmarrje të mbyllur me formë të shoqërisë tregtare (shoqëri e investimeve me kapital fiks) dhe me formë kontraktore (fondet e investimeve), të cilat

janë të përshtatshme për të bërë investime jo-likuide, të tilla si: pasuri të paluajtshme. Ligji 10198 lejonte sipërmarrjet në formën e shoqërisë së investimit, por investimet e lejuara ishin sipas kërkesave të Direktivës së UCITS, kështu që nuk mund të investonin në aktive jo-likuide. Teknikisht, këto janë fonde të investimeve alternative.

Sa i përket fondeve të investimeve alternative që u ofrohen vetëm investuesve profesionistë, ato duhet të regjistrohen pranë AMF-së për shitje të investuesit profesionistë në Shqipëri, pavarësisht nëse janë fonde vendase apo të huaja. Këto mund të jenë fonde të investimeve me pjesëmarrje të hapur, me intervale ose me pjesëmarrje të mbyllur, shoqëri të investimeve me pjesëmarrje të mbyllur, ose shoqëri komandite. Këto janë fonde të investimeve alternative sipas DAFIA-së dhe rregullohen vetëm nga kërkesat që lidhen me këtë direktivë. Sipas ligjit të ri, fondet alternative, që lejohen të marketohen dhe t'u shiten vetëm investuesve profesionistë, vetëm regjistrohen pranë AMF-së dhe nuk rregullohen nga Autoriteti, megjithëse administruesi i fondeve të investimeve alternative dhe depozitari i fondeve të investimeve alternative rregullohen nga AMF, siç e kërkon Direktiva.

Ligji i ri për SIK parashikon edhe struktura të reja fondesh, si më poshtë:

- Sipërmarrje ombrellë,
- Sipërmarrje kryesore (ka qenë referuar në Ligjin Nr.10198, por jo e përkufizuar dhe përshtatur),
- Sipërmarrje furnizuese e investimeve kolektive (ka qenë e përkufizuar por jo e mundësuar plotësisht në ligjin Nr.10198).

Sa i përket sipërmarrjeve të huaja të investimeve kolektive, ligji i ri lejon njohjen e SIK në letra me vlerë të transferueshme (SIKLVT/UCITS)

me ofertë publike – në përputhje me Direktivën UCITS (DSIKLVT-së), sipas së cilës çdo sipërmarrje e licencuar në vendin e origjinës mund të marketohet përtej kufijve në çdo shtet anëtar të BE-së ose ZEE-së. Gjithashtu, AMF mund "të njohë" edhe fondet e investimeve alternative që nuk janë SIKLVT, por që mund të ofrohen publikisht në vendin e origjinës. Njohja është objekt i kërkesave ligjore dhe njohja automatike e SIKLVT, që do të jetë e detyrueshme në momentin kur Shqipëria të bëhet shtet anëtar i Bashkimit Evropian, është e parashikuar por sipas dispozitave kalimtare do të zbatohet vetëm kur Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, në përputhje me DSIKLVT dhe DAFIA, në Ligj parashikohet që shoqëria administruese e themeluar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, ose administruesi i fondeve të investimeve alternative njihen nga AMF, në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE – Shqipëri.

Parashikimi në ligj i formave dhe strukturave të reja të sipërmarrjeve përbën potencial për zhvillimin e këtij tregu, duke krijuar mundësi të reja investimipëriinvestuesit dhe qytetarët shqiptarë dhe njëkohësisht rrit aksesin në burime të reja financiare për biznesin shqiptar. Me hyrjen në fuqi të Ligjit 56/2020 "Për SIK", për AMF-në sfida qëndron në ngritjen e bazës rregullatore në zbatim të këtij ligji, si dhe forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të këtij tregu, në kushtet e krijimit të produkteve të reja alternativave të këtij tregu. Gjithashtu, përputhshmëria me kërkesat e ligjit të ri të veprimtarisë së shoqërive administruese dhe fondeve të administruara prej tyre, përbën një sfidë si për operatorët në tregu, ashtu edhe për autoritetin mbikëqyrës të tij.

# Studimi i VISA-s: Rikthim në Biznes: Si e ri-formatoi COVID-19 të ardhmen e tregtisë



**Vladimir DJORDJEVIC**

Drejtor i Përgjithshëm  
VISA PËR EVROPËN JUGLINDORE

**M**e daljen e vaksinave dhe kur po duken shenja të rimëkëmbjes së ekonomisë botërore, pas parashikimit për rritje ekonomike prej 5.5% për 2021<sup>1</sup>, gradualisht po pozicionohemi në një normalitet të ri. Pavarësisht se shitjet tradicionale me pakicë nuk janë rikthyer ende në nivelet e para pandemisë, konsumatorët që ishin të "mbyllur" për ca kohë janë të etur të dalin dhe pronarët e bizneseve janë po të etur për të rihapur bizneset. Parashikimet për shitjet tradicionale me pakicë (në dyqane fizike) nuk janë të njëjta, që nga koha kur filloi mbyllja. Vajtja në dyqane, zgjedhja e frutave dhe perimeve dhe biseda me shitësit ende përbëjnë një realitet të rëndësishëm gjatë blerjeve dhe do të mbeten një mënyrë popullore e blerjes për shumë blerës. Por, edhe pse një numër i konsiderueshëm klientësh po i kthehen përsëri dyqaneve, bumi brenda natës në

tregtinë elektronike (e-Commerce), i përshpejtuar nga shpërthimi i koronavirusit, është tashmë një fakt i përhershëm. Ajo që shohim tani është ndryshimi i modelit të blerjeve dhe krijimi i një harmonizimi të veçantë midis blerjeve nëpërmjet internetit dhe atyre në dyqan. Si rezultat, NMV-të vazhdojnë të bëjnë ndryshime të rëndësishme, për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve, që nga zgjerimi i pranisë së tyre në tregtinë elektronike, deri te pranimi i formave të reja të pagesave pa kontakt në dyqane.

## Preferencat dhe pritshmëritë e konsumatorëve

Gjatë pandemisë, shumë konsumatorë filluan të blejnë, për herë të parë, në internet mallrat e domosdoshëm - një pjesë e madhe e tyre realizuan blerjen e parë të ushqimeve në internet, ndërsa të tjerë kryen blerjen e tyre të parë në internet nga farmacitë. Si rezultat, ajo që u vu re ishte një rritje e konsiderueshme e tregtisë në segmentet e ushqimeve dhe barnave, ku tregtia elektronike ka qenë thëllësisht minimale. Mundësia për të blerë thuajse çdo produkt nga komoditeti dhe siguria e shtëpisë çoi në një pëlqim masiv të blerjeve në internet - madje dhe konsumatorët më ngurrues e të frikësuar për të "shtypur" butonin e transportit, filluan të shijonin mënyrën e re të blerjes dhe pagesës. Si një rrjet global pagesash dhe motor i tregtisë, shoqëria VISA zotëron një panoramë unike të zakoneve të kryerjes së pagesave, përmes pranisë së saj në

tregjet kombëtare. Të dhënat e VISA tregojnë se disa vende evropiane po regjistrojnë një rritje të tregtisë elektronike me rreth 25%, krahasuar me periudhën parapandemike, ndërsa në Shqipëri blerjet në internet u rritën me 13.5% gjatë vitit 2020<sup>2</sup>.

Por ndoshta ndryshimi më i madh, për sa i përket modelit të blerjes, është kthesa drejt teknologjisë pa kontakt, në pikat e shitjeve. Përdorimi i pagesave pa kontakt u bë pjesë e përgjigjes së shëndetit publik, por komoditeti dhe besueshmëria e teknologjisë po e përforcojnë këtë model, duke e kthyer atë në një prirje afatgjatë. Nga studimi i ri i VISA-s për biznesin pohohet se, më shumë se gjysma e konsumatorëve kanë përdorur pagesa pa kontakt, kur kanë pasur mundësi, ndërsa dy të tretat deklarojnë që pas vaksinës do të preferonin të përdorin pagesa pa kontakt edhe më shumë sesa i përdorin aktualisht. VISA ka punuar me partnerë të industrisë së pagesave dhe qeveritë, në më shumë se 50 tregje, për të rritur kufijtë e transaksionit të pagesave, në mënyrë që konsumatorëve të mos i kërkohet nënshkrimi dhe pagesat pa kontakt të mund të rriten edhe më shumë. Në Shqipëri, kufiri është rritur me 22%, duke u dhënë konsumatorëve më shumë komoditet për transaksionet e përditshme.

## Rruga e rimëkëmbjes për NMV-të

Pronarët e bizneseve të vogla u goditën më rëndë nga rënia ekonomike. Në rajonin e CEMEA-s<sup>3</sup>, rreth 60% dhe 89% e tregtarëve kanë përjetuar rënie mesatare të

<sup>1</sup> Sipas <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2021/01/26/2021-world-economic-outlook-update>

<sup>2</sup> Sipas të dhënave të VISA'net për transaksionet kombëtare me karta VISA, për periudhën T4 2019-T4 2020.

shpenzimeve<sup>4</sup>, ndërsa në Shqipëri rreth 71% e firmave raportuan ulje të kërkesës<sup>5</sup>. Më shumë janë prekur shitësit që operojnë me para<sup>6</sup> në dorë, ndërsa tregtarët që përdorin internetin dhe u përshtatën duke përdorur pagesat pa kontakt arritën të përballonin më mirë vështirësitë ekonomike. Sipas studimit të VISA-s: "Rikthim në biznes", rreth 83% e NMV-ve kanë ndryshuar mënyrën e funksionimit të biznesit të tyre gjatë muajve të fundit, kryesisht të nxitur nga përshtatjet digjitale, të tilla si: shitja e produkteve dhe shërbimeve në internet, reklamat në mediat sociale si dhe digjitalizimi i funksioneve të biznesit, të tilla si: operacionet e pagesave nga klientët fundorë. Një shenjë e mirë është se shumë nga NMV-të janë të vetëdijshme për rëndësinë e transformimit digjital dhe besojnë se ndjeshmëria dhe përgjigjja e tyre ndaj pandemisë mund të bëjë dallimin midis suksesit dhe dështimit. Me një numër mbi 160.000 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme që veprojnë në Shqipëri, NMV-të përfaqësojnë një kontribues jetik në zhvillimin e ekonomisë<sup>6</sup>. Shumë prej tyre janë përpjekur gjithashtu ta mbajnë biznesin të paprekur, duke u mbështetur në një mentalitet digjital dhe duke u përpjekur të krijojnë eksperiencën më të mirë për klientin – deri në 77% e firmave shqiptare raportuan se i përshtatën operacionet e tyre në përgjigje të krizës<sup>7</sup>. Megjithë përshtatjet e rëndësishme ndaj digjitalizimit, lëvizja drejt tregtisë në internet ka qenë sfiduese. Ndërsa pengesat e sotme me të cilat përballen NMV-të mund të jenë të reja për disa, VISA është munduar t'i japë zgjidhje problematikave që lidheshin me pagesat e tregtarëve për dhjetvjeçarë

me rradhë. Nga një këndvështrim më i gjerë, VISA po e përqendron strategjinë e saj në ndërtimin e mjedisit të tregtisë digjitale, e cila do t'i bëjë blerjet dhe pagesat në internet po aq të lehta sa dhe ato me prani fizike. Këtu ekzistojnë shumë mundësi, por fokusi i shoqërisë është që t'i ndihmojë bizneset kudo që janë të përmirësojnë eksperiencën e klientit, duke ofruar zgjidhjet më të besueshme dhe të sigurta për pagesat.

### 2021-shi – Viti i sigurisë

Nëse viti 2020 ishte viti i rritjes së tregtisë pa kontakt dhe i asaj elektronike, viti 2021 do t'i kushtojë vëmendje më të madhe sigurisë dhe mbrojtjes ndaj mashtrimeve. Në të gjithë Evropën Qendrore, Lindjen e Mesme dhe Afrikë, ka pasur rritje të sulmeve të inxhinierisë sociale, përfshirë phishing, ku mashtruesit kanë shfrytëzuar boshllëqet që ekzistonin para pandemisë dhe i kanë intensifikuar gjatë saj. Ndërkohë që ecim përpara, bizneset gjithnjë e më shumë e kuptojnë se vetëm digjitalizimi nuk mund të sigurojë një tregti të qetë dhe të sigurt. Transformimi i vërtetë digjital u mundëson bizneseve t'u shërbejnë klientëve në internet përmes efikasitetit, personalizimit, njohjes së kërkesave të tyre, e mbi të gjitha, sigurisë. Studimi i ri i VISA-s tregon se pronarët e bizneseve të prirur ndaj teknologjisë (52%) kanë më shumë gjasa se homologët e tyre fillestarë (39%) të investojnë në sigurinë dhe mbrojtjen nga mashtrimet. Pandemia i ka detyruar disa biznese të përshtatë transformimin e tyre digjital, duke lënë jashtë ekuacionit menaxhimin e rreziqeve. Bizneset e vogla, që duhet ende të investojnë në sigurinë e pagesave

dhe parandalimin e mashtrimeve, duhet t'i japin përparësi përqendrimin në këtë fushë gjatë 2021-shit, pasi mashtruesit po sofistikohen gjithnjë e më shumë. Mbrojtja e konsumatorëve nga mashtrimi nuk duhet të jetë një detyrë shqetësuese për sipërmarrësit – zotërimi i mjeteve të duhura dhe bashkëpunimi me një partner me përvojë e të besuar është një mënyrë për të patur sukses në këtë fushë.

### Transformimi digjital – Së bashku më mirë

Teknologjitë digjitale kanë siguruar një prani të përheshme dhe do të bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, jo vetëm për të mbështetur rimëkëmbjen e ekonomisë globale, por për të fuqizuar motorin e tregtisë globale. Me pasigurinë e shkaktuar nga pandemia, që do të vijojë të jetë e pranishme në të ardhmen e afërt, viti 2021 mund të sjellë edhe më shumë transformim. Megjithëse mundësia digjitale nuk garanton fundin e krizës, transformimi digjital mund të përqafohet nga shumë njerëz si prirje e përgjithshme ekonomike dhe të krijojë mundësi të reja për bizneset e vogla. Mbetet në dorën e qeverive, institucioneve financiare dhe bizneseve të punojnë ngushtë së bashku për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për pranimin e pagesave digjitale, por gjithashtu të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut rreth lehtësive dhe përfitimeve që vijnë nga risitë në mënyrat e pagesës. VISA ka përqendruar burimet dhe përvojën e saj në rrugët për t'i ndihmuar të gjitha palët e përfshira që të kalojnë përmes këtyre ndryshimeve të mëdha

<sup>3</sup> Evropa Qendrore, Lindja e Mesme dhe Afrika.

<sup>4</sup> VISA Merchant Study

<sup>5</sup> Sipas <https://blogs.worldbank.org/developmenttalk/covid-19-impact-albanias-private-sector-taking-stock-looking-ahead>

<sup>6</sup> Sipas <https://china-cee.eu/2019/11/26/albania-economy-briefing-albanian-small-businesses-in-their-quest-for-survival/>

<sup>7</sup> Sipas <https://blogs.worldbank.org/developmenttalk/covid-19-impact-albanias-private-sector-taking-stock-looking-ahead>

# Konvertimi i kolateralit në projektet e financimit të ndërtimit të infrastrukturës<sup>1</sup>

*Legjislacioni shqiptar ofron mundësi ligjore efektive për të maksimizuar sigurinë e financuesve në projektet e financimit të ndërtimit të rrjeteve infrastrukturore dhe të ngjashme me to.*



**Av. Ardjana SHEHI KALO**

MBA CIPD

Në projektet e ndërtimit të rrjeteve hekurudhore, gazsjellës, naftësjellës, etj., sfida është financimi i tyre, krahas çështjeve ligjore në zënien e territoreve të ndërtimit, etj. Mbi të gjitha, siguri i kolateralit për këto projekte të financimit, me vet pasuritë që blihen, krijohen dhe ndërtohen gjatë fazës së zbatimit të tyre, është pika që rrit shanset për mundësimin e financimit, zbatimin dhe mbylljen me sukses të këtyre projekteve.

Trajtimi i konvertimit të llojit të kolateralit, nga ai mbi pasuri të luajtshme në barrë kolaterale mbi pasuri të paluajtshme, është në varësi të përkufizimit ligjor të "pasurisë së luajtshme" dhe të "pasurisë së paluajtshme". Përkufizimi i Kodit Civil për "sendet e paluajtshme" përfshin sendet e lidhura me tokën dhe çdo

gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën, ose ndërtesën; sendet e tjera, përfshirë dhe çdo energji tjetër natyrore, janë "sende të luajtshme".

Për trajtimin e çështjeve të kolateralit dhe të konvertimit të tij, së pari, duhet vlerësuar nëse, gjatë ndërtimit të rrjetit infrastrukturor përkatës, do të ketë transformim të pasurive të luajtshme në pasuri të paluajtshme. Sendet e luajtshme, që për shkak të instalimit/montimit dhe/apo punimeve ndërtimore krijojnë një lidhje të përhershme me tokën, fitojnë të drejtën për t'u përfshirë në përkufizimin si sende të paluajtshme, pikërisht në çastin dhe për shkak të aftësisë së fituar për të qenë të paluajtshëm në raport me tokën. Kështu, për shembull: copat e tubave të cilët, pas ndërtimit, montohen/instalohen dhe shtrihen si tubacione mbi tokë dhe nën tokë, për nga natyra e tyre, kur realizohet blerja janë sende të luajtshme. Por, këto sende të luajtshme, për shkak të cilësive që fitojnë pas punimeve të montimit/instalimit dhe ndërtimore, ku përmendim edhe punimet për lidhjen e tyre të përhershme me tokën, sipas nenit 142 të Kodit Civil, marrin cilësinë e sendeve të paluajtshme.

Sfida në trajtimin ligjor është lloji i ndryshëm i mjeteve të sigurimit të ekzekutimit të detyrimit apo i kolateralit që zbatohet për pasuritë e luajtshme, apo për

pasuritë e paluajtshme, kur ato përdoren si mjete të sigurimit të financimeve. Në këtë kuptim, pyetja tjetër që shtrohet gjatë analizës ligjore është: cili është lloji i mjetit të sigurimit të ekzekutimit të detyrimit që përdoret mbi sendet e luajtshme përkatëse dhe cili është mjeti përkatës për sendet e paluajtshme?

Në legjislacionin shqiptar mënyrat për të siguruar ekzekutimin e detyrimit me një send të luajtshëm janë nëpërmjet pengut posedimor dhe barrës siguruese jo-posedimor. Në praktikën në Shqipëri, pengu posedimor pothuaj nuk përdoret në projektet e financimit dhe, aq më pak, në rastet e investimeve të mëdha. Kjo për arsye se nuk shihet e përshtatshme që sendi i luajtshëm të bllokohet dhe të mos përdoret, por edhe për shkak se, duke nisur nga viti 1999, pjesë e legjislacionit shqiptar është Ligji nr.8537/1999 "Për barrët siguruese", i ndryshuar, që parashikon në mënyrë të hollësishme pengun jo-posedimor. Në projektet në fjalë, shihet si një zgjidhje e përshtatshme përdorimi i pengut jo-posedimor, i cili vendoset mbi sendin e luajtshëm në formën e "barrës siguruese". Në këtë lloj pengu, sendi i luajtshëm përdoret gjatë projekteve përkatëse të ndërtimit dhe ai perfeksionohet me regjistrimin në Regjistrin e Barrëve Siguruese (neni 8 i Ligjit për Barrët Siguruese). Perfeksionimi/

<sup>1</sup> Ky artikull nuk përbën këshillë ligjore.

regjistrimi i kolateralit është edhe mjeti për të vendosur prioritetin e preferimit të pretendimeve, gjatë ekzekutimit të të njëjtit send të luajtshëm të përdorur si kolateral për disa kreditorë, si dhe midis barrës siguroese të kompletuar ndaj asaj të pakompletuar (neni 11 i Ligjit për Barrët Siguroese).

Sendi i luajtshëm shërben si kolateral për financimin përkatës deri në momentin e transformimit në send të paluajtshëm, pra, pasi montohet/instalohet dhe bashkohet nëpërmjet punimeve ndërtimore në lidhje të përhershme me tokën dhe cilësohet si send i paluajtshëm. Në legjislacionin shqiptar (nenet 560 e 562 i Kodit Civil), hipoteka kontraktore është mjet i sigurimit të ekzekutimit të detyrimit, e cila përfaqëson një të drejtë reale të barrëmarrësit mbi pasurinë e paluajtshme të huamarrësit ose të një të treti, në dobi të kreditorit, për të siguruar përmbushjen e një detyrimi të huamarrësit.

Për qëllime të projekteve infrastrukturore, duhet të vlerësohet nëse legjislacioni parashikon mundësinë e krijimit dhe perfeksionimit të një mjeti sigurimi të ekzekutimit të detyrimit mbi sendet e paluajtshme të ardhshme. Ndërkohë që hipoteka kontraktore mund të krijohet me kontratë (neni 562 i Kodit Civil), duhet të mbahet parasysh se, në bazë të nenit 567 të Kodit Civil, hipoteka mund të regjistrohet vetëm kur të ekzistojë sendi. Pra, sipas kësaj dispozite, hipoteka mbi një send të paluajtshëm të ardhshëm mund të jetë efektive vetëm kur të ekzistojë sendi i paluajtshëm. Lidhur me këtë, duhet të vlerësohet se cili është çasti që formalisht e konsideron sendin e paluajtshëm të krijuar, pra që "sendi i paluajtshëm ekziston". Për këtë, ajo pjesë e legjislacionit

shqiptar që ka të bëjë me zhvillimin e pronave të paluajtshme dhe ndërtimet jep orientim dhe zgjidhje për projektet në fjalë.

Në kushtet kur në disa projekte infrastrukturore kemi transformim të sendit të përdorur si kolateral, nga send i luajtshëm në send të paluajtshëm, si dhe kur kemi lloje të ndryshme mjete sigurimi detyrimi, veçmas për sendet e luajtshme dhe sendet e paluajtshme, sfidë ligjore është konvertimi i kolateralit, pa cënuar asnjë çast interesin e financuesve, prioritetin e tyre, por edhe vazhdimësinë pa ndërprerje të mbulimit të financimit me kolateral efektiv.

### **Çfarë është konvertimi i kolateralit?**

"Konvertim" nuk është "përtëritja" e kolateralit. Lidhur me kolateralin, termi "konvertim" përdoret këtu për analogji, për shkak të mundësisë së transformimit të sendit, objekt kolateralit. Por, konvertimi i vet kolateralit bëhet nëpërmjet "zëvendësimit" të llojit të kolateralit; në projektet në fjalë, kemi të bëjmë me zëvendësimin e mjetit të sigurimit të ekzekutimit të detyrimit, nga forma e "barrës siguroese" në formën e "hipotekës". Në këtë rast shtrohet pyetja: si mund të bëhet ky zëvendësim në mënyrë të sigurt? Konvertimi i kolateralit nëpërmjet zëvendësimit, nëse nuk ka kujdes ligjor, mund ta lërë financuesin kreditor pa mbulim me kolateral gjatë kohës së këtij konvertimi, e kjo për shumë shkaqe ligjore që nuk trajtohen në këtë shkrim. Vetëm nëpërmjet kujdesit ligjor, mund të maksimizojmë sigurinë e financuesve në këto projekte komplekse. Si zgjidhje ligjore përkatëse është e rëndësishme të përmendet se nuk duhet të pretendohet të vendoset hipotekë e thjeshtë dhenë mënyrë konsekuente,

pas transformimit të sendit të luajtshëm në send të paluajtshëm. Krijimi i hipotekës kontraktore mbi sendin e ardhshëm të paluajtshëm që krijohet duket që mund të krijojë komfort ligjor. Procedura e krijimit të hipotekës kontraktore, regjistrimi/perfeksionimi i saj mbi sendin e paluajtshëm të ardhshëm duhet të koordinohet dhe mbivendoset me çlirim/shuarjen e barrës siguroese, të krijuar dhe regjistruar/perfeksionuar në momentin që barrëdhënësi bëhet pronar i sendit të luajtshëm. Për qëllime të zëvendësimit të sigurt të kolateralit, duhet konsideruar edhe se regjistrimi i barrës siguroese bëhet në një regjistër të vetëm qendror Regjistri i Barrëve Siguroese dhe hipoteka ende regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme të vendit ku ndodhet pasuria e paluajtshme. Po kështu, duhet konsideruar çështja e shuarjes së barrës siguroese dhe hipotekës, si pika ligjore që duhen mbajtur në vëmendje, ashtu siç duhet të mbahet në kujdes edhe çasti i kalimit të titullit të pronësisë së sendit të paluajtshëm të krijuar te kreditori hipotekar, shtrirja e hipotekës mbi servitutin përkatës (neni 564 i Kodit Civil) dhe radha e hipotekës dhe zbatimi i parimit *pari passu* gjatë ekzekutimit të hipotekës, sipas neneve 574, 575 e 576 të Kodit Civil.

Legjislacioni shqiptar ofron mundësi ligjore efektive për të maksimizuar sigurinë e financuesve në projektet e financimit të ndërtimit të rrjeteve infrastrukturore dhe të ngjashme me to. Sfidat e zbatimit në praktikë të zgjidhjeve ligjore të mësipërme janë të shumta edhe pse praktika gjyqësore nuk i ka prekur ende këto çështje dhe zgjidhjet ligjore përkatëse.

# PAKETA E PAGËS



**PËRFITO:**

Deri në 6 paga  
Overdraft

Kartë Krediti me  
0 komision vitin e 1<sup>rë</sup>  
Kartë Debiti Falas

Deri në 10% skonto  
për çdo Kredi Konsumatore



Mobile Banking  
**FALAS**



**Fibank**  
First Investment Bank



# German Sparkassenstiftung dhe BMZ

## Së bashku për të përmirësuar edukimin dhe përfshirjen financiare në Shqipëri

### Anja DEINZER

Drejtoresha Rajonale, Shqipëri  
GERMAN SPARKASSENSTIFTUNG FOR  
INTERNATIONAL COOPERATION

Viti 2020 ka qenë një vit sfidues për të gjithë, kështu që dhe sektori financiar nuk bën përjashtim. Çdo biznes po përjeton shtrëngesa dhe po punon për t'i kapërcyer sfidat që ka prodhuar pandemia COVID-19. Në këto kohë të vështira, German Sparkassenstiftung für internationale Kooperation filloi projektin e saj të parë në Shqipëri, vetëm disa muaj më parë. Projekti: "Forcimi i njohurive financiare në Republikën e Shqipërisë", ka në fokus mbështetjen e individëve, biznesit të vogël dhe mikro-bizneseve, përmes programeve të trajnimit për njohuritë financiare, si dhe promovimin dhe ofrimin në mënyrë të vazhduar të edukimit financiar dhe atij profesional.

### German Sparkassenstiftung në botë

German Sparkassenstiftung for International Cooperation është një agjenci zbatuese e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). German Sparkassenstiftung mbështet partnerët qeveritarë, jo-qeveritarë dhe të sektorit privat për të realizuar bashkërisht masat e zhvillimit, duke synuar rritjen e shërbimeve financiare të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe mbështetjen për sipërmarrës të mikro dhe të vegjël, si dhe fermerët. Nëpërmjet forcimit të strukturave financiare vendase dhe rajonale, si dhe duke promovuar njohuritë financiare dhe sipërmarrëse, German

Sparkassenstiftung gjeneron jo vetëm mundësi zhvillimi për një pjesë të gjerë të popullsisë, por në finale ndihmon në krijimin e vendeve të punës dhe të ardhurave.

### 1992: Krijimi i German Sparkassenstiftung

Në vitin e largët 1961, qeveria egjiptiane i kërkoi Shoqatës Gjermane të Bankave të Kursimeve (DSGV) ndihmesë për krijimin e kooperativave të kreditit përgjatë Deltës së Nilit. Në vitet '80, Sparkassen e Gjermanisë mori në mënyrë të përsëritur kërkesa për mbështetje nga vendet në zhvillim, që dëshironin të krijonin institucione financiare. Sparkassen-Finanzgruppe nisi kështu projekte në Azi (Bangladesh, Kinë dhe Sri Lanka), e gjithashtu në Afrikë (Botsvanë, Kenia, Namibi dhe Uganda). Në Amerikën Latine, ajo filloi të veprojë në Kolumbi dhe Peru.

Rënia e Perdes së Hekurt dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik nxorën sfida të reja për Sparkassen-Finanzgruppe, të cilit iu desh të ristrukturohej organizativisht, për të mundur funksionimin në ekonominë sociale të tregut të ish-RDGJ-së. Pas përfundimit të kësaj sfide, u vijua me një rritje të numrit të kërkesave për mbështetje nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Sparkassen-Finanzgruppe iu përgjigj kësaj kërkesë ndërkombëtare për ekspertizë dhe përvojë, duke themeluar German Sparkassenstiftung für internationale Kooperation, duke u përqendruar në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, si dhe duke zgjeruar angazhimin e saj në politikën e zhvillimit, në ekonominë në

zhvillim.

### 2020: German Sparkassenstiftung fillon të veprojë në Shqipëri

Në qershor të vitit 2020 German Sparkassenstiftung dhe BMZ filluan një projekt të ri në Shqipëri, që synon të ndihmojë në përmirësimin e edukimit dhe përfshirjes financiare në vend. Objektivi i përgjithshëm i projektit: "Forcimi i njohurive financiare në Republikën e Shqipërisë", është përmirësimi i kushteve socio-ekonomike të jetesës së popullsisë në Shqipëri. Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes për individët, biznesin e vogël dhe mikro-bizneset, përmes programeve të trajnimit për njohuritë financiare dhe duke promovuar e siguruar në mënyrë të vazhdueshme arsimin profesional dhe financiar, projekti vepron drejt realizimit të këtyre objektivave. Projekti e vë theksin në zonat rurale të Shqipërisë, ku përqendrohen masat për zhvillimin e grupeve e synuara për fitimin e aftësisë sipërmarrëse si: menaxhimi financiar, kontabiliteti, planifikimi i biznesit dhe planifikimi i emergjencave.

Duke punuar ngushtë me institucionet partnere në Shqipëri, ekspertët tanë bankarë të German



Mendo globalisht, vepra lokalisht,  
bashkëpunimi ndërkombëtarisht.

Sparkassenstiftung mbështesin dhe rrisin aftësinë për të hartuar dhe zbatuar programe të edukimit financiar të bazuara në nevoja, të cilat janë zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme në bashkëpunim me aktorët shtetërorë dhe nisma të tjera të dhuruesve në zonat rurale të Shqipërisë.

Projekti filloi zyrtarisht në 2 nëntor 2020, me një takim-diskutimi online të grupeve të interesit, ku u paraqit zyrtarisht projekti dhe u ndanë rezultatet e vlerësimit të misionit të tij me pjesëmarrës nga institucionet private dhe publike, përfshirë Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Gjatë dhe pas periudhës së vlerësimit të misionit të projektit (qershor-shtator, 2020), ekspertët tanë të German Sparkassenstiftung identifikuan nevojën për ndërhyrje, duke synuar të përmirësojnë edukimin dhe njohuritë financiare, në drejtim të përmirësimit të përfshirjes financiare dhe të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri.

Pavarësisht periudhës së shkurtër kohore dhe sfidave të shumta, për sa i përket pandemisë COVID-19, është treguar shumë interes nga grupe të ndryshme interesi, të cilat janë materializuar në marrëveshje me disa OJQ, që veprojnë në zonat rurale të Shqipërisë, si dhe me operatorë në tregjet financiare. Ne kemi prezantuar një metodologji të re, duke përfshirë lojën tonë edukuese në një mjedis virtual me një metodologji interesante edukimi, të cilat mund t'i ndihmojnë familjet, bizneset e vogla dhe fermerët për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Projekti ynë realizon një kurs edukues: "trajnimi të trajnerëve" për organizatat partnere, ku pjesëmarrësit mësojnë se si të drejtojnë pjesëmarrësit nga publiku përmes "lojës" së edukimit financiar, duke shumëfishuar kështu arritjen e aftësive dhe njohurive të edukimit financiar. Këto trajnime janë vlerësuar

shumë nga të gjithë pjesëmarrësit e disa institucioneve dhe OJQ-ve. Gjithashtu, disa prej tyre kanë filluar tashmë t'i shumëfishojnë virtualisht këto trajnime për përfituesit e tyre.

Suksesi i zbatimit të këtij instrumenti edukues qëndron në mundësinë për të përfshirë banorë dhe gra me fëmijë të vegjël në zona të largëta, që ndryshe nuk do ishin në gjendje të ndiqnin një trajnim fizikisht, e që gjithashtu mbështet tri parimet bazë të German Sparkassenstiftung: bashkëpunimi i bazuar në partneritet, në frymën e besimit të ndërsjellë; transferimi i faktorëve kyç të suksesit nga Sparkassen-Finanzgruppe; dhe zbatimi e zgjidhjeve të orientuara drejt praktikës. Të gjitha institucionet shqiptare, me të cilat punon Sparkassentiftung, nuk perceptohen si klientë, por si partnerë. Duke u angazhuar në një frymë besimi të ndërsjellë, ne promovojmë zhvillimin e qëndrueshëm dhe punojmë me ato për të krijuar marrëdhënie profesionale afatgjata.

Nuk ka dyshim se, seancat e trajnimit mund të ndihmojnë në përmirësimin e edukimit financiar për segmente të caktuara të popullsisë, por ne mendojmë se vetëm trajnimi nuk mjafton. Kjo është arsyeja pse, që nga fillimi, një nga qëllimet e projektit ka qenë krijimi i marrëdhënieve me organizatat të ndryshme kombëtare dhe lokale, si: Rrjeti Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE) dhe anëtarët e tij: Banka e Shqipërisë, Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Arsimit dhe Sportit, universitetet dhe agjencitë shtetërore. Ne jemi të ndërgjegjshëm se, për të shpjeguar vizionin tonë për rritjen e edukimit financiar, duhet të ndërmerren veprime dhe kërkohet bashkëpunim i fortë midis të gjithë "aktorëve", në mënyrë që të kapërcejmë sfidat. Në këtë drejtim, kemi ofruar kontributin tonë në këtë proces, i cili konsiston në kompetencat, njohuritë dhe sigurisht në përvojën tonë më të mirë.

Jemi të lumtur të vërejmë se ekziston një mirëkuptim i përbashkët me shumicën e aktorëve që kemi pasur mundësinë të takohemi. Jemi të kënaqur me bashkëpunimin dhe marrëdhëniet që kemi krijuar me ANFE dhe anëtarët e saj, si: Shoqata Shqiptare e Bankave, Shoqata Shqiptare e Siguruesve, Junior Achievement, si dhe Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës. Me kënaqësi kemi pranuar ftesën për të qenë anëtar i ANFE-së, duke filluar nga marsi i 2021-shit. Ky, për mendimin tonë, është një reagim pozitiv ndaj përpjekjeve dhe kontributit të German Sparkassenstiftung gjatë këtyre muajve të parë të projektit. Së bashku me anëtarët e tjerë, do të bëjmë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar Bankën e Shqipërisë në hartimin e një Strategjie Kombëtare të Edukimit Financiar, duke punuar për të sjellë ekspertizën e duhur dhe përvojat pozitive, nga vendet e tjera të botës.

### **Ndajmë njohuritë, ekspertizën, sikundër profesionalizmin dhe punën e palodhur!**

Ne jemi të vetëdijshëm se të gjitha këto veprimtari dhe përpjekje janë mundësuar falë stafit profesionist. Ne jemi vetëm katër persona si staf lokal që, falë aftësive, kemi punuar me të gjithë partnerët. Në sajë të profesionalizmit dhe përkushtimit të ekipit, kemi arritur të përparojmë shumë, brenda një kohe të shkurtër. Në zyrën tonë, "ekip" do të thotë shumë dhe pavarësisht se çfarë ndodh, ne ndihmojmë dhe mbështetemi te njëri-tjetri. Të gjithë lëvizim në të njëjtin drejtim, me të njëjtin drejtim. Me këtë frymë, jemi shumë optimistë se do të përmbushim objektivat e fazës orientuese të projektit, deri në fund të majit 2022 dhe do të jemi gati për tre vitet e fazës së zbatimit në vijim.

*Vetëm mund të bëjmë shumë pak; së bashku mund të bëjmë shumë më shumë!*

# Etika dhe e Ardhmja e Punës - nga “a mundemi” te “si duhet”

## Një vështrim nëpërmjet lentes së pandemisë



### Roden PAJAJ

Drejtor për Shërbimet e Konsulencës së Kapitalit Njerëzor  
DELOITTE SHQIPËRI & KOSOVË

Deloitte Albania prej tre vitesh mat prirjet e zhvillimit të kapitalit njerëzor në Shqipëri, si pjesë e një studimi global të kryer nga Deloitte Network në të gjithë botën. Në vërtetimin mbi këto prirje në Shqipëri për vitin 2020, “Etika dhe e Ardhmja e Punës” u rendit si një ndër prirjet kryesore të zhvillimit. “E ardhmja e punës”, - që para pandemisë - ka qenë një temë e nxehtë diskutimi në tregjet e zhvilluara, e nxitur nga zhvillimi i shpejtë teknologjik. Me sa duket, pandemia Covid-19, si një makinë e së ardhmes, e solli shumë më shpejt botën e biznesit në të ardhmen e punës, tashmë një domosdoshmëri jo vetëm për të mbijetuar, por gjithashtu edhe për të lulëzuar në normalitetin e ri. “E ardhmja e punës”, që kishim projektuar në të ardhmen afatmesme, është tani.

Trysnia e pandemisë përshpejtoi jetësimin e teknologjive digjitale, e për rrjedhojë, edhe nevojën për

rikonceptimin e vet punës, forcave të punës dhe të vendit të punës, veçanërisht drejt punës në distancë dhe asaj hibride. Në përgjigje të pandemisë, disa nga korporatat në vend, përfshirë dhe insitucionet financiare, krijuan kushtet e domosdoshme për mundësimin e punës në distancë. Disa prej tyre po vlerësojnë për ta kthyer këtë në një model të ri të kryerjes së punës. Me integrimin e njeriut me teknologjinë, të forcave alternative të punës dhe mënyrave të reja të të punuarit, sfidat e etikës bëhen më kokëfortë, sidomos aty ku ndërthuret elementi njerëzor me teknologjinë. Nisur nga këto zhvillime, pyetje të reja etike ngrihen mbi ndikimin e këtyre teknologjive në forcën e punës dhe shoqërinë si e tërë.

### Hendeku Rëndësi - Gatishmëri

Rreth 78% e pjesëmarrësve në vërtim në Shqipëri pohojnë se prirja: “Etika dhe e ardhmja e punës” është e rëndësishme ose shumë e rëndësishme në suksesin e kompanisë, por vetëm 57% e tyre shprehën se janë gati për ta trajtuar këtë prirje.

Zhvillimi i teknologjisë – çfarë u vërtetua dhe në këtë kohë pandemie – po e vështirëson më shumë ruajtjen e ekuilibrit punë-jetë, konfidencialitetin e të dhënave, apo ruajtjen e privatësisë. Pyetjet kryesore që ngre ky zhvillim janë: *Si ndikohet mënyra e kryerjes së punëve (detyrave) nga teknologjia? Zbatimi i teknologjive të reja në procesin e punës ka për qëllim vetëm reduktimin e kostove të punës, apo krijimin e vlerës*

*nëpërmjet integritit të teknologjisë dhe aftësive njerëzore? Cili është ndikimi social nëse fokusohemi vetëm te reduktimi i kostove? Si do të mundemi të monitorojmë ecurinë e forcës së punës në këtë realitet të ri? Do të vijojmë të vlerësojmë përpjekjet e dukshme të punonjësve në një mjedis zyre, apo produktin përfundimtar të punës së tyre?*

Për të kuptuar më shumë për zhvillimet në tregun shqiptar në këtë fushë, në vërtimin tonë të kryer përpara shpërthimit të pandemisë, ngritëm ndër të tjera, dy pyetje kryesore. Në pyetjen e parë synonim të kuptonim se cilat janë shqetësimet kryesore për organizatat shqiptare, lidhur me trajtimin etik të së ardhmes së punës dhe sa gati janë ato për t'i trajtuar ato, ndërsa e dyta synonte të evidentonte nxitësit kryesorë që e bëjnë këtë çështje të marrë kaq rëndësi.

Privatësia dhe kontrolli i të dhënave të punonjësve rezultoi një nga shqetësimet parësore (për 65.38%), e ndjekur nga trajtimi i drejtë me pagë

### Shqetësimet kryesore etike në lidhje me të ardhmen e punës në organizatën tuaj




<sup>1</sup> Deloitte Albania, Raporti mbi Trendet e Kapitalit Njerëzor, 2020, “Ndërmarrja sociale në veprim: Paradoksi si një formë zhvillimi”

<sup>2</sup> <https://www2.deloitte.com/al/sq/pages/human-capital/solutions/trendet-e-kapitalit-njerezor-2020.html>

<sup>3</sup> E ardhmja e punës është një rezultat i tre dimensioneve të cilat po ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme: Puna (çfarë), Forca e punës (kush) dhe vendi i punës (ku), Future of work\_Deloitte, 2020

<sup>4</sup> European Group on Ethics in Science and New Technologies, Future of Work Future of Society, fq. 59

## Sa gati është organizata juaj për të menaxhuar këtë shqetësim?



(për 46.15%), përdorimi i Inteligjencës Artificiale dhe i të dhënave për monitorimin e punonjësve dhe të mjedisit të punës (për 42.31 %) dhe menaxhimi i ndikimit të automatizimit të proceseve të punës në fuqinë

## Çfarë e nxit rëndësinë e shtuar të menaxhimit të çështjeve të etikës të lidhur me të ardhmen e punës?



## Si e parashikoni rëndësinë e menaxhimit të çështjeve të etikës lidhur me të ardhmen e punës të ndryshojë në tre vitet e ardhshme?



punëtore (për 30.77 %).

Për sa i përket nivelit të gatishmërisë së organizatave të biznesit pjesëmarrëse në vrojtim, për adresimin e tyre ushprehën se janë më pak gati nga pikëpamja e aftësive dhe kapaciteteve, lidhur me “Përdorimin e algoritmeve në vendimmarrje” dhe “Menaxhimin e forcës alternative të punës” (me 33.33 %). Është i njohur fakti që, shkalla e automatizimit të proceseve të punës në Shqipëri dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale në vendimmarrje, me përjashtime në sektorë specifik, si ai bankar dhe i telekomunikacionit, nuk është e njëjtë me atë të vendeve të zhvilluara.

Nga ana tjetër menaxhimi dhe trajtimi i drejtë i forcave alternative të punës, apo “*forcave të padukshme të punës*”, është një dukuri në zhvillim në realitetin e tregut shqiptar të punës. Në vendet e zhvilluara, ky segment i forcave të punës është një dukuri në rritje, çfarë ka ngritur dhe shqetësime etike si: qasja e tyre në paga të drejta, kujdes shëndetësor dhe përfitime të tjera që ju njihen punonjësve tradicionalë. Ky fenomen listohet gjithashtu si një nga nxitësit kryesorë të rëndësisë së trajtimit të etikës në të ardhmen e punës në Shqipëri, sipas të dhënave të raportit tonë.

Këto të dhëna dëshmojnë edhe njëherë rëndësinë në rritje të një qasje etike për të ardhmen e punës.

Për këtë arsye, në ndërthurjen e teknologjisë me elementin njerëzor, në normalitetin e ri të punës në distancë dhe asaj hibride, pyetja lidhur me etikën e të ardhmes së punës zhvendoset nga: “*a mundemi*” në “*si duhet*” të zbatohet teknologjia në rikonceptimin e vetë punës, modelit të ri operativ të biznesit dhe të shërbimeve ndaj konsumatorit!

<sup>4</sup> Bertrand Liard and Clementine Durney, “The European Strategy for regulation of artificial intelligence,” White & Case LLP, August 29, 2019. 2020 Deloitte Global Human Capital Trends

<sup>5</sup> 2020 Deloitte Global Human Capital Trends 2021 Global Human Capital Trends | Deloitte Insights

<sup>6</sup> Në SHBA numri i të vetë-punësuarve vlerësohej të arrinte në 42 milionë në vitin 2019, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar ekonomia gig është dyfishuar nga viti 2016 në vitin 2019 duke arritur në 4.7 milionë. 2020 Deloitte Global Human Capital Trends 2021 Global Human Capital Trends | Deloitte Insights

## PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE E KORPORATËS



### ALPHA BANK

- Nën moton "Të dua jetël!", stafi i bankës, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, organizoi në datat 1 dhe 8 prill, për të njëmbëdhjetin vit radhazi, "Ditën e Dhurimit të Gjakut".
- Në datë 12 mars u zhvillua online "Forumi Ekonomik i Tiranës". Një nga folësit kryesorë ishte Z. Georgios Papanastasiou, Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania dhe President i Shoqatës së Biznesit Grek në Shqipëri, i cili foli se si pandemia COVID-19 e testoi ekonominë Shqiptare në përgjithësi dhe sistemin bankar në veçanti, por pavarësisht rritjes së pasigurisë, sistemi bankar vijoi të ketë një pozicion financiarisht të qëndrueshëm, me një shkallë të lartë likuiditeti, të mbështetur me kapitale më se të mjaftueshme, duke e bërë kështu një nga aktorët kryesorë në rimëkëmbjen e ekonomisë Shqiptare.



- Mbështeti Qendrën Shëndetësore Malësi e Madhe, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe për të rritur cilësinë e shërbimit për rreth 5,000 pacientë dhe aksesit në sistemin shëndetësor elektronik, duke përpiluar protokollet mjekësore online, si dhe botimin e një formati libër.
- Në mbështetje të institucioneve që ofrojnë shërbim për komunitetin, financoi Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vlorë (ASHK) dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Lezhë, për të përmirësuar mjediset e punës.
- Dhuroi pajisje për të përmirësuar infrastrukturën e IT, duke nxitur inovacionin teknologjik për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Devoll (ASHK).

stomatologë.

- Mbështeti "Tirana Economic Forum".
- Dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve të punës në institucionet: Kryqi i Kuq, Dega Elbasan, Komandën e Forcave Tokësore, Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare, Forcat Ajrore Shqiptare.
- Vazhdon projektin për shtimin e stacioneve të biçikletave pranë çdo dege, jo vetëm në Tiranë, por dhe në qytetet: Elbasan, Korçë, Sarandë e Vlorë.
- Mbështeti gjelbërimin e qendrës së qytetit të Fierit.
- Mbështeti Shoqatën Kulturore VIZart, në realizimin e eventit "VIZart", një ekspozitë që bën bashkë punët e 50 mjeshtrove shqiptarë, që i përkasin brezave të ndryshëm.
- Mbështeti Shoqatën e Volejbollit "Partizani" në mbulimin e shpenzimeve për uniformat sportive të ekipit dhe shpenzime të tjera gjatë kampionatit.



- Startoi nismën më të re: "Food Bank", ku çdo muaj do të jetë pranë familjeve në nevojë. Banka shpërndau ndihma ushqimore në mbi 80 familje në nevojë, në qytetin e Tiranës dhe Kavajës.
- Mbështeti organizimin e Konferencës Kombëtare të Shkencave Mjekësore 8, që përfshin 10 webinar-e për mjekët klinikistë, 10 webinar-e për farmacistët dhe 10-15 webinar-e për mjekët



- Financoi projektin e Qendrës Arsimore të qytetit të Fierit, për pajisjen me kamera sigurie të 4 kopshteve e çerdheve.
- Përgjegjësia sociale është pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të Fibank dhe një nga kauzat që janë mbështetur në vazhdimësi



Banka Amerikane e Investimeve mbështeti për të pestin vit radhazi YWCA - Albania, në nismat për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e kancerit të gjirit. Nën moton: "Fjongo rozë na kujton se zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit, na shpëton jetën", YWCA – Albania çeli fushatën e 13-të saj, me ambasadorë të kauzës soprano me famë botërore, Ermonela Jaho.



**WE TAKE CARE  
OF WHAT YOU  
CARE ABOUT**



**Intesa Sanpaolo Bank Albania**

**GLOBAL BANKING &  
Finance  
review**

**#ALWAYSTOGETHER**

 **INTESA SANPAOLO BANK**  
Albania

    [www.intesasnpaolobank.al](http://www.intesasnpaolobank.al)

CONTACT CENTER  
08006000 ( Free from Albtelcom ) +355 4 2276000, +355 692080903

Bank of **INTESA**  **SANPAOLO**



është ajo e Fondacionit "Down Syndrome Albania". Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Bozhidar Todorov u falënderua nga ky fondacion me një certifikatë mirënjohje.



- Intesa Sanpaolo Charity Fund\* i jep Shqipërisë 452,330 euro, përmes 3 projekteve në qytete dhe zona rurale, që prekin drejtpërdrejt më shumë se 3,600 përfitues.

Konkretisht:

1. Projekti "UNE KUJDESEM - Veprimet e reagimit ndaj emergjencave pas tërmetit në Shqipëri", zbatohet nga OJQ-ja Italiane AVSI, në bashkëpunim me partnerin e saj lokal SHIS, në katër zona kryesore: Durrës, Sukth, Thumanë dhe Bubq. Kohëzgjatja e projektit është 16 muaj dhe përfituesit janë afërsisht 1,500 persona.

2. Projekti: "Ndërhyrjet psiko-shëndetësore gjatë emergjencës COVID-19 dhe emergjencës pas tërmetit në Shqipëri", zbatohet në Lezhë, Bubq dhe Thumanë. Kohëzgjatja e projektit është 12 muaj dhe përfituesit e tij janë 1,050 persona.

3. Projekti "URBAN LAB" është aprovuar në vitin 2021 dhe do të zbatohet në bashkinë e Divjakës,

Fier. Kohëzgjatja e projektit është 12 muaj dhe përfituesit e tij janë 1,130 persona.

*\*Fond për kontribute bamirësie, shoqërore dhe kulturore, që sigurohet nga Statuti i Intesa Sanpaolo, koordinohet nga Kryetari i bordit të bankës dhe lejon shpërndarjen e një pjese të fitimeve të paspërndara për bamirësi, si dhe për të mbështetur projekte që lidhen me solidaritetin, shoqëror, dobinë dhe vlerën e individit.*

- Fushatat e ndërgjegjësimit të mbështetura:
- Fushatë ndërgjegjësimi kundra mashtrimeve kibernetike,
- 1 mars 2021: Dita e Diskriminimit Zero!
- 3 mars 2021: Dita Botërore e Jetës së Egër,
- 8 Mars 2021: Dita Ndërkombëtare e Gruas,
- 21 mars 2021: Dita Botërore e "Sindromës Down",
- Ora e Tokës 60 +, më 27 mars 2021 @ 8: 30-9: 30 pasdite, duke marrë masa për planetin dhe natyrën! Zyra qendrore fiku dritat, duke iu bashkuar fushatës.
- Intesa Sanpaolo Bank Albania përgatiti dhe shpërndau 3 video, lidhur me veprimtaritë në kuadër të edukimit financiar, përmes një platforme masive në internet, që përdoret gjithashtu për klasat në internet: ACADEMIA.al.Videot përmbanin informacion mbi Kursimet dhe Riciklimin:
- Fëmijë dhe Kursime

- Varet nga Ju!
- Rilindja e mbeturinave edhe fëmijët mund të riciklojnë.
- Banka u vlerësua si "Best CSR Bank Albania 2021" nga revista prestigjioze ndërkombëtare Global Banking Finance.



## ProCredit Bank

Përmes një marrëveshjeje me Bankën Evropiane të Investimeve, ProCredit Bank Albania po mbështet bizneset e vogla dhe të mesme (NVM) dhe ndërmarrjet që kanë më pak se 3,000 punonjës (MidCaps), duke siguruar akses në një burim të paçmuar të financave me kosto më të ulët dhe një plan fleksibël pagesash.



- Është kthyer në një traditë tashmë mbështetja e ICT Awards, që startoi më 27 mars 2021 me edicionin e 9-të, nën mbështetjen e Raiffeisen Bank, si sponsor gjeneral.
- Në kuadër të mbështetjes që Raiffeisen i jep artit dhe kulturës dhe si sponsor gjeneral i Teatrit Kombëtar, u mbështet Festivali Mbarëkombëtar të Teatrit "MOISIU"-ON, i cili u mbajt virtualisht në datat 23 shkurt-16 mars.





- Banka beson në brezin e ri dhe në idete e tyre inovatore. Me këtë mendim në mendje, mbështeti projektin "Start Up City 3", të organizuar nga Universiteti Metropolitan Tirana.
- Nën moton "Jetoshëndetshëm" sponsorizoi Bashkinë Tiranë për prodhimin e pesë stacioneve për parkimin e biçikletave.
- Në kuadër të organizimit të Konferencës Kombëtare të Shkencave Mjekësore 8 me temë: "Sfidat e profesionistëve të shkencave mjekësore gjatë pandemisë Covid-19", Banka OTP Albania dha ndihmën e saj në organizimin e kësaj veprimtarie, që këtë vit u mbajt online.
- Dhuroi një sasi të konsiderueshme karrigesh, kompjuterësh dhe mobiljesh për një sërë institucionesh vendore dhe lokale, në mbarë vendin. Kështu, gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 u dhuruan gjithsej 60 karrige të modeleve të ndryshme, për njësitë vendore në rrethet: Laç, Pogradec, Sarandë,

Lezhë, Berat, Tiranë dhe gjashtë kompjutera në rrethin e Fierit.

- Në kuadër të promovimit të turizmit në Shqipëri, Banka OTP Albania mbështeti Bashkinë Gramsh për prodhimin e 61 tabelave orientuese për zonat turistike të këtij rrethi.

## TIRANA BANK


- Kontribuoi për Shkollën 9-vjecare "5 Dëshmorët" në Ksamil, duke krijuar kushte optimale për 540 nxënësit e saj.
- Banka inauguroi projektin: "Tarracat e Gjelbra", në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Zgjerimi i zonave të banuara dhe i infrastrukturës së qytetit të Tiranës kërkon vëmendje të veçantë dhe kjo është një përgjegjësi sa individuale aq edhe kolektive. Përkushtimin ndaj mjedisit, e shprehim nëpërmjet projekteve me natyrë simbolike, por me standarde etike dhe sociale të larta, duke pasqyruar këtë vlerë të integruar në filozofinë e

veprimtarisë së Tirana Bank".

- Në këtë 8 Mars, Banka zgjodhi të ofrojë një mundësi më të mirë, për një grua dhe një nënë, të drejtat e së cilës janë shkelur. Nën kujdesin e veçantë të Z.Dritan Mustafa, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, u vlerësua bashkëpunimi me Albanian Woman's Empowerment Network (AWEN), OJF e themeluar në vitin 2009 dhe me një rrjet prej 9 organizatash lokale në të gjithë Shqipërinë.

## UNIONBANK

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Union Bank lançoi në muajin mars një ofertë të posaçme, për të gjitha gratë dhe vajzat. Qëllimi i kësaj pakete të dedikuar ishte rritja e mëtejshme e mundësisë së aksesit të gjinisë femërore në kryerjen e veprimeve bankare. Të gjitha klienteve vajza dhe gra që vizituan degët e bankës gjatë ditës së 8 Marsit iu dhurua nga një lule në shenjë mirënjohjeje dhe respekti ndaj tyre.





# JAVA E PARASË

2021

Gjatë javës së 22-28 mars 2021, Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe partnerë të tjerë, organizuan veprimtari të ndryshme, në përputhje me rregullat kombëtare të sigurisë shëndetësore anti-COVID-19, me qëllimin e promovimit të përpjekjeve që synojnë përmirësimin e edukimit financiar të të rinjve.

"Kujdesu për veten, kujdesu për paratë e tua" ishte tema zyrtare e Javës së Parasë 2021. Kjo temë theksoi rëndësinë e krijimit të qëndrueshmërisë financiare dhe të qëndrimit i shëndetshëm, në kontekstin aktual.

Java e Parasë 2021 përfshiu në mënyrë aktive më shumë se 500 nxënës dhe studentë, nga më shumë se 130 shkolla, të të gjithë cikleve.

## E martë, 23 mars 2021

Më 23 mars 2021, Banka e Shqipërisë hapi Javën e Parasë, në një ceremoni online ku përshëndetën Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë; Znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Pas përshëndetjeve të rastit, veprimtaria vazhdoi me shpërndarjen e çmimeve për fituesit e 4 konkurseve, të lançuara më parë nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave, AAB.

Konkursi i parë, i organizuar gjatë kësaj jave, ishte "Vizatimi më i Mirë", me temë: "Kujdesu për vete, kujdesu për paratë e tua", drejtuar nxënësve të klasës së 5-të të shkollave fillore të vendit. Ky konkurs u mbështet nga Alpha Bank Shqipëri.

Konkursi i dytë ishte ai me fotomontazhe, me temë: "Kujdesu për vete, kujdesu për paratë e tua", i cili iu drejtua nxënësve të klasave të 8 & 9-ta të shkollave fillore. Konkursi u mbështet nga FIBank Shqipëri.

Konkursi i tretë ishte ai për videon më të mirë. Nxënësit e shkollave të mesme u ftuan të përçojnë mesazhet e tyre origjinale në lidhje me temën: "Kujdesu për veten, kujdesu për paratë e tua". Konkursi u mbështet nga Tirana Bank.

Konkursi i katërt, për postimin më të mirë në Facebook, për temën: "Ndikimi i Covid-19 në ekonomi dhe kujdesi për financat personale në periudha pandemie", drejtuar studentëve të fakulteteve të Ekonomisë dhe Financë-Bankë, u mbështet nga OTP Bank Shqipëri.


## E enjte, 25 mars 2021

### Finalet shqiptare të Konkursit Evropian të Parasë 2021

Më 25 mars 2021, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), organizuan për herë të tretë Konkursin Evropian të Parasë, me pjesëmarrjen e 360 nxënësve të moshës 13-15 vjeç, nga e gjithë Shqipëria. Këtë vit konkursi mbi edukimin financiar u zhvillua online dhe pjesëmarrësit garuan si një ekip përmes platformës Kahoot!, në një veprimtari të drejtpërdrejtë në kanalën e AAB-së në YouTube.

Ky konkurs është bërë një traditë vjetore dhe synon përmirësimin e njohurive financiare të fëmijët dhe të rinjtë.

Skuadra fituese ishte nga shkolla "Sotir Gurra", Korçë dhe përbëhet nga: Pandush



Kosta dhe Anastasia Myftarlli. Kjo skuadër fituese përfaqëson Shqipërinë për herë të tretë në finalet e Konkursit Evropian të Parasë, në 20 prill 2021.

### Takim me studentët






Më 25 mars 2021, Dr. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB), zhvilloi një takim & leksion online me studentë të Departamentit të Ekonomiksit & Financës, në Universitetin Evropian të Tiranës (UET). Tema e këtij takimi ishte përfshirja dhe edukimi financiar, si dhe bankat tregtare.

## E Premte, 26 mars 2021

### Leksion i Hapur

AAB, në bashkëpunim me Universitetin Evropian të Tiranës (UET) organizuan, në 26 mars 2021, një leksion të hapur me studentë të Departamentit të Ekonomiksit & Financës. Gjatë këtij leksioni, të mbajtur nga Znj. Ediola Bıçaku, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në Intesa Sanpaolo Bank Albania, studentët u njohën me rolin dhe funksionet e auditit të brendshëm në sektorin bankar.

*Faleminderit të gjithëve që morën pjesë dhe mbështetën realizimin e këtyre veprimtarive!*



## AAB AKTIVITETE

### Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mori pjesë në trajnimin: "Aksesi në financa".

Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë organizoi një trajnim dy-ditor online me temë: "Aksesi në financa", më 13-14 janar 2021, ku morën pjesë 80 pjesëmarrës. Gjatë dy ditëve u diskutuan disa temat të rëndësishme, si: ndikimi i efekteve të pandemisë COVID-19 në veprimtarinë e biznesit në Shqipëri dhe sfidat për rimëkëmbjen ekonomike; roli i bankave dhe institucioneve financiare në kapërcimin e krizës dhe mbështetjen e biznesit me produkte dhe shërbime novatore, etj.

Dr. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB, si një nga pjesëmarrësit në trajnim, shpjegoi rolin e bankave, si aktorë kyç të sistemit financiar, investimet e bankave në edukimin financiar dhe mundësitë e financimit të biznesit.

Ky trajnim online u zhvillua në kuadër të mbështetjes së BE-së për "Forum-in e Investimeve të

Dhomave të Tregtisë së Ballkanit Perëndimor".

### Leksion i hapur online

Dr. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB, zhvilloi një leksion të hapur online, në 2 shkurt, me temë: **"Ekonomia, përfshirja financiare dhe bankat"** me pjesëmarrjen e studentëve nga Fakulteti i Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës. Leksioni ngjalli me interes të madh për pjesëmarrësit.

### Trajnim mbi Falimentimin

Më 23 - 25 mars, AAB së bashku me IFC-në mundësuan pjesëmarrjen e juristëve të bankave në trajnimin online: **"Për avokatët e bankave dhe palët e interesuara për çështje reale të falimentimit në Shqipëri"**. Në trajnim morën pjesë 26 juristë të bankave. Pjesëmarrësve iu ndanë dhe certifikata.

### Takim informues me ekipin e Bankës Botërore

Më 24 mars, Sekretari i

Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim virtual me ekipin e Bankës Botërore. Gjatë takimit, Dr. Brumbulli paraqiti një pasqyrë të sektorit bankar dhe projektin për raportimet në Bankën e Shqipërisë, sipas standardeve të SNRF-ve.

### Fushata për përdorimin e kartave

Më 1 mars, AAB filloi fushatën për përdorimin e kartave, e cila synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për përdorimin e pagesave me karta debiti dhe krediti, si dhe të nxjerrë në pah përfitimet e përdorimit të tyre. Mesazhi përcillet përmes metaforës së një lidhje dashurie. Efikasiteti i përdorimit të kartës si mjet pagese u realizua përmes tre videove dhe u trajtua në formën e një letre drejtuar "dashurisë" së vjetër (kartëmonedhës), duke krahasuar cilësitë e dy mjeteve të pagesës dhe duke theksuar arsyen e zgjedhjes së përdorimit të kartës, kundrejt parasë fizike.

Fushata do të zgjasë për dy muaj dhe mbështetet nga VISA.

## TRAJNIME

AAB, në bashkëpunim me AIIA, organizoi trajnimin me temë: **"Identifikimi dhe Minimizimi i Mashtrimit dhe Keqpërdorimit"** më 2- 4 shkurt 2021. Kursi u zhvillua me synim përditësimin e pjesëmarrësve me prirjet dhe sjelljet aktuale të atyre që synojnë, me ose pa dashje, të shkaktojnë humbje ose dëme në organizatë. Trajnimi u ndoq nga 11 pjesëmarrës.

AAB, në bashkëpunim me AIEA, organizoi trajnimin mbi **"Design Thinking"**, më 16-17 shkurt & 24 shkurt 2021. Ky trajnim ofroi një prezantim të parë, por të thellë, lidhur me Design Thinking, si një metodë për menaxhimin e shërbimeve, produkteve, proceseve dhe modeleve novatore të biznesit, si dhe u mundëson praktikuesve që të mësojnë përmes rasteve praktike. Në trajnim morën pjesë 17 pjesëmarrës nga bankat anëtare.

**"Planifikimi Strategjik"**, ishte një trajnim tre-ditor i ofruar nga AAB në bashkëpunim me AIEA, më 9-11 mars 2021. Gjatë këtij trajnimi ndërveprues, pjesëmarrësit, të ndarë në ekipe të vogla, mësuuan se si të përpilonin plane strategjike. Në trajnim morën pjesë 14 pjesëmarrës.

Në datat 23-26 & 30-31 mars, trajnimi **"Financimi i Projekteve"** u ofrua nga AAB, në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të ATTF/Shtëpia e Trajnimeve Luksemburg. Kursi ofroi një program bazik në financimin e projekteve, duke iu paraqitur 15 pjesëmarrësve një ekspozitë të kësaj çështje, që i pajis ata të bashkëveprojnë me specialistë, ose për të vijuar me studime më të thelluara, në fushat e tyre të interesit.

